

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6009
E martë, 25 shkurt 2020
çmimi 0.40 €

Kurti: Evropa mund të bëjë më shumë për Ballkanin Perëndimor



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



FLET PËR "EPOKËN E RE", IBRAHIM GASHI | FAQE 4-5

PEZULLIMI I TAKSËS DO TË ISHTE ZGJIDHJE E BALANCUAR

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka bërë me dije se qeveria e re duhet të gjejë një zgjidhje optimale rreth taksës 100 për qind ndaj mallrave serbe. Në këtë intervistë dhënë përgazetën "Epoka e re", ai ka thënë se pezullimi i taksës mund të ishte një zgjidhje e balancuar. Sipas tij, kjo do të ndikonte në ruajtjen e marrëdhënieve të mira të Republikës së Kosovës me ShBA-në dhe BE-në. Ai ka vlerësuar se parimi i reciprocitetit me Serbinë do të ishte masë vështirë e aplikueshme në të gjitha aspektet. Gashi ka theksuar se qeveria e re duhet të ketë objektiva të qarta programore për trajtimin e problemeve që shteti ynë ka përparrë në planin ndërkombëtar.



OPINION



KU JETON ALI AHMETI

F. 12
Nga Ismet SYLEJMANI

AKTUALE

NË KOSOVË NUK KA TË PREKUR NGA KORONAVIRUSI F. 7

UP-JA NDAN MBI 1 000 BURSA PËR STUDENTËT F. 6

FUSHATA ZGJEDHORE PËR KRYETAR TË PODUJEVËS FILLOM MË 3 MARS F. 3

EKONOMI

MË 1 MARS NË GJERMANI HYN NË FUQI LIGJI PËR FUQINË PUNËTORE TË KUALIFIKUAR F. 8

AAK-ja: TAKSA NUK DUHET TË HIQET DERI NË NJOHJEN RECIPROKE F. 8

KULTURË

NJË AUTORE QË HEDH HAPIN GUXIMSHËM DHE SUKSESSHËM NË LETËRSINË PËR FËMIJË F. 13

Prof. As. Dr. Astrit BISHQEMI

SPORT

HOXHA: SYNOJMË FITORE KUNDËR PRISHTINËS NË 'FADIL VOKRI' F. 16

RENOVA
PUTZ
Makedoni Xheqisht-Tetovë Curë-Ferizaj Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
PRINCESHA GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

044/256-051
044/367-061
028/532-617
Bunjamini
MITROVICË
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADE

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Trumpi thotë se Grenelli do ta vazhdojë angazhimin në bisedimet Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 24 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, ka thënë se i dërguari i tij për dialogun Kosovë - Serbi, ambasadori Richard Grenell, ka bërë një punë fantastike dhe se do të vazhdojë të jetë i dërguar për dialogun. Trump ka bërë me dije se do të emërojë një ambasador të ri në Gjermani.

I pyetur nga "Zeri i Amerikës", presidenti e konfirmoi se ambasadori Grenell do të vazhdojë të shërbëjë si i dërguar i posaçem për bisedimet Kosovë - Serbi. "Do të emëroj një ambasador të ri ri në Gjermani. Ambasadori (Grenell) do të vazhdojë (si i dërguar për Kosovën dhe Serbinë) pasi po bën një punë shumë të mirë. Ai i njeh mirë zyrtarët. Ka bërë punë fantastike. Do ta vazhdojë. Të gjithë thoshin se ishte një marrëveshje e paarritshme, por ai e realizoi. Ishte diçka shumë pozitive për këto të dy vende", ka deklaruar presidenti Trump duke iu referuar marrëveshjeve të fundit përihapjen e transportit ajror dhe hekurudhor Kosovë - Serbi.



Kurti: Evropa mund të bëjë më shumë për Ballkanin Perëndimor

Kryeministri i Republikës së Kosovës Albin Kurti në Samitin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka thënë se ne mendojmë që Evropa mund të bëjë më shumë, diçka që po vjen nga Evropa për Ballkanin Perëndimor dhe që ne e vlerësojmë shumë tështë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim pasi që fjalë kyçë e saj janë investimet

PRISHTINË, 24 SHKURT - Kryeministri i Kosovës Albin Kurti, për herë të parë ka marr pjesë në Samitin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), për investimet në Ballkanin Perëndimor që po mbahet në Londër. Në këtë samit, kryeministri Albin Kurti, ka folur për rëndësinë e investimeve në Kosovë dhe ka thënë se BERZH-i duhet të ndajë mjete financiare për Kosovën.

Kurti ka theksuar nevojën që Kosova ka veçanërisht për infrastrukturë hekurudhore dhe rrugë që do ta lidhin Kosovën më shumë me fqinjët e saj.

Kryeministri Albin Kurti ka folur nga paneli i diskutimeve në kuadër të Samitit të Londrës. Ai edhe një herë ka folur për planin e mini-Marshallit që ai po ia sugjeron Bashkimit Evropian.

"75 vjet më parë Evropa Perëndimore e kishte Amerikën dhe Marshall planin e saj. Ne kemi BE-në. Dhe çfarë mendojmë që ne do të bënim

më mirë, tështë se ne mendojmë që Evropa mund të bëjë më shumë. Diçka që po vjen nga Evropa për Ballkanin Perëndimor dhe që ne e vlerësojmë shumë tështë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Sepse fjalë e tyre kyçë tështë investimi dhe s'mund të pajtohesha se sa me shtyjet e rritjes ekonomike dhe rritjen e punësimeve të njerëzve, veçanërisht të të rinjve dhe të grave. Për më pak se 30 vjet, kanë dhënë gati 30 miliardë euro në mbi 700 projekte të ndryshme. Dhe ne si Qeveri e re duam që të bashkëpunojmë me BERZH-in, me planin tonë qeverisës dhe frysës së tyre të mirë dhe investimeve të duhura edhe më shumë se në të kaluarën", ka thënë Kurti.

Duke folur për prioritetet e qeverisjes së tij, Kurti i ka kërkuar BERZH-it të bashkëpunojë me të për rritjen ekonomike të Kosovës.

Ndërkohë, në një intervistë për medie Kurti ka shpalosur objektivat e qeverisë që udhëheq.



Ai ka thënë se luftimi i korruptionit do të jetë prioritet për të. "Ne do të fokusohemi në zbatimin e ligjit për ta luftuar korruptionin dhe përgarantuar investimet dhe nga ana tjetër ne do të lidhim tregun e punës me edukimin e duhur dhe përkëtëna duhet një infrastrukturë e mirë, e veçanërisht transporti hekurudhor, në të cilën BERZH-i do të mund të na ndihmojë shumë dhe rrugët rajonale që të kemi lidhje më të mirë si brenda vendit dhe me fqinjët. Ne kemi një rini mjaft të arsimuar në aspektin teknologjik, por neve na duhen

investimet e duhura. Po ashtu, ne kemi nevojë për investime të huaja që të kemi rritje ekonomike", ka deklaruar Kurti. Më tutje, ai ka theksuar se ndihma e BERZH-it i nevojitet Kosovës për të rehabilituar transportin rrugor dhe atë hekurudhor. "Në drejtim të kësaj, ne do të fokusohemi që ta lidhim Prizrenin me Tetovën, po ashtu rehabilitimin e transportit hekurudhor nga jugu në veri, duke filluar nga Hani Elezit kufirit me Maqedoninë e Veriut, dhe në drejtim të Leshakut në kufi me Serbinë. Ky Samit ishte

një mundësi e mirë që të diskutojmë me shefat e vendeve të tjera", ka thënë Kurti, duke shtuar se investimet e diasporës do ta ndihmonin Kosovën. Në këtë samit ka marrë pjesë edhe kryeministri shqiptar, Edi Rama, i cili ka thënë se tështë e rëndësishme që në Londër janë mbledhur liderët e rajonit të Ballkanit Perëndimor, dhe edhe pse vendet kanë probleme dhe mosmarrëveshje me njëratjet e rastin e Kosovës me Serbinë, ky rajon po ec përparrë për të ardhmen duke lënë pas hakmarjet, gjakderdhjet dhe urrejtjet.

CDU e Merkelt pëson humbje të madhe në Hamburg

BERLIN, 24 SHKURT - Partia e kancelares gjermane, Angela Merkel, pësoi humbje të madhe në zgjedhjet rajonale në Hamburg.

Unioni i saj Demokristian po kalon nëpër një krizë të liderisë, pasi udhëheqësja e partisë, Anegret Kramp-Karrenbauer, njoftoi se do të japë dorëheqje.

Sipas rezultateve paraprake të

zgjedhjeve të së dielës, Të Gjelbrit shënuan fitore të madhe në Hamburg, duke dalë partia e dytë me 24.1 për qind të votave, ndërsa Social-Demokratët pritet të mbeten partia më e madhe, me 39.1 për qind.

Unioni Demokristian ra në vendin e tretë, me rrëth 11% të votave.

Sekretari i përgjithshëm i

Demokristianëve, Paul Ziemiak, tha se ishte një "ditë e hidhur". Partia e ekstremit të djathtë, Alternativa për Gjermaninë, mund të kualifikohet për disa ulëse në parlamentin rajonal. Votimet u zhvilluan pak ditë pas një sulmi racist në qytetin Hanau të Gjermanisë, ku mbetën të vrarë nëntë persona.



Konjufca dhe Cakaj nga Selaniku kërkojnë liberalizimin e vizave për Kosovën



Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, në konferencën e nivelit të lartë për perspektivën Evropiane të Ballkanit Perëndimor "Nga Selaniku në Zagreb", që po mbahet në Selanik, ka kërkuar liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Të njëjtën gjë e ka kërkuar edhe ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme i Shqipërisë, Gent Cakaj. Të dy ministrat shqiptarë kanë theksuar përkushtimin e institucioneve të dy vendeve për t'i vazhduar reformat në rrugën e integrimit evropian

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

SELANIK, 24 SHKURT - Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës i Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, po merr pjesë në konferencën e nivelit të lartë për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor "Nga Selaniku në Zagreb" që po mbahet në Selanik, me pjesëmarrjen e she-

fave të diplomatice të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe në prani të Presidencës kroate të Bashkimit Evropian, Shërbimit të Jashtëm të BE-së si dhe përfaqësuesve të Komisionit Evropian. Në fjalimin e mbajtur në këtë konferencë, ministri Konjufca ka kërkuar marrjen e vendimit pozitiv për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës, në mënyre që rinia e

Kosovës të mos izolohet nga perspektiva e saj. Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka theksuar përkushtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për t'i vazhduar reformat në rrugën e integrimit evropian. "Kam siguruar se zhvillimi ekonomik dhe social, fqinjësia e mirë dhe dialogu me Serbinë janë qëllimet afatgjatë të qeverisë së re për t'i kontribuar dhe siguruar paqen

rajonale", ka thënë Konjufca. Në kuptim të zhvillimeve të reja në rrugën evropiane, ministri i Jashtëm dhe i Diasporës ka përshëndetur metodologjinë e re të aprovuar nga komisioni si dhe ka shprehur bindjen pozitive për samitin në mes të vendeve të BE-së dhe atyre të Ballkanit Perëndimor, i planifikuar të mbahet në muajin maj në Zagreb.

Gjatë qëndrimit në Selanik, ministri Konjufca i është përgjigjur edhe interesimit të mediave greke për qëndrimet e Republikës së Kosovës dhe qeverisë së re lidhur me zhvillimet në rajon dhe integrimin e Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian.

Në Konferencën e Nivelit të Lartë për Perspektivën Evropiane në Selanik, edhe ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme

i Shqipërisë, Gent Cakaj, ka kërkuar liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. "Nënvizuam rëndësinë e veçantë të liberalizimit të vizave me Republikën e Kosovës jo vetëm për qytetarët e saj, por edhe për ta ruajtur besueshmërinë e BE-së në rajon. Theksuam domosdoshmërinë për t'i hapur negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut: kjo masë është thelbësore për t'i thelluar reformat e brendshme, forcuar procesin e bashkëpunimit rajonal e lartësuar frymën evropiane në Ballkanin Perëndimor në përgjithësi. Gjithë pjesëmarrësit në këtë takim mbështesin pa hezitim hapjen e bisedimeve për anëtarësim në BE për Shqipërinë menjëherë sipas meritave të saj madhore", ka shkruar Cakaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Fushata zgjedhore për kryetar të Podujevës fillon më 3 mars

PRISHTINË, 24 SHKURT (ER) - Fushata parazgjedhore për kryetar të Komunës së Podujevës do të fillojë më 3 mars dhe do të zgjasë deri më 13 mars. Lajmin e ka bërë me dije për "Epokën e re" zëdhënësi i Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi. "Komisioni Qendorr i Zgjedhjeve ka vendosur që fushata zgjedhore për subjektit politike dhe kandidatët garues për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar

të Komunës së Podujevës të fillojë më 3 mars dhe të përfundojë më 13 mars. Pra, janë gjithsej 11 ditë në dispozicion të subjekteve politike dhe kandidatëve për ta zhvilluar fushatën e tyre zgjedhore", ka thënë Elezi.

Ai ka theksuar se më 2 mars KQZ-ja do ta organizojë tërheqjen e shortit për renditjen e subjekteve politike dhe kandidatëve në fletëvotimin e këtyre zgjedhjeve. "Vetëm një ditë para fillimit të fushatës zgjed-

hore Komisioni Qendorr i Zgjedhjeve do ta organizojë tërheqjen e shortit për renditjen e subjekteve politike dhe kandidatëve në fletëvotimin e këtyre zgjedhjeve", është shprehur Elezi.

Në garë për zgjedhjet për kryetar të Podujevës janë tre kandidatë: Nexhami Rudari nga LDK-ja, Naim Fetahu nga PDK-ja dhe Shpejtim Bulliqi nga Lëvizja Vetëvendosje. Zgjedhjet për kryetar të Podujevës mbahen pas



emërimit të Agim Velut në Brendshme dhe Administratës Publike. të postin e ministrit të Punëve të

FLET PËR "EPOKËN E RE", IBRAHIM GASHI

Pezullimi i taksës do të is

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka bërë me dije se qeveria e re duhet të gjejë një zgjidhje optimale rrith taksës 100 për qind ndaj mallrave serbe. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se pezullimi i taksës mund të ishte një zgjidhje e balancuar. Sipas tij, kjo do të ndikonte në ruajtjen e marrëdhënieve të mira të Republikës së Kosovës me ShBA-në dhe BE-në. Ai ka vlerësuar se parimi i reciprocitetit me Serbinë do të ishte masë e vështirë e aplikueshme në të gjitha aspektet. Gashi ka theksuar se qeveria e re duhet të ketë objektiva të qarta programore për trajtimin e problemeve që shteti ynë ka përpëra në planin ndërkombëtar

EPOKA ERE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 SHKURT - Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka ftuar qeverinë e re që t'i ruajë marrëdhënet e mira me ShBA-në dhe BE-në. Ai ka thënë pezullimi i taksës ndaj mallrave serbe do të ishte një zgjidhje e balancuar, e cila do t'i ruante raportet e mira të Republikës së Kosovës me aleatët e saj perëndimorë. Në këtë intervistë dhënë për gazeten "Epoka e re", Gashi ka treguar se reciprociteti do të jetë vështirë i zbatueshëm në të gjitha aspektet në raport me Serbinë. "Qeveria e re duhet ta gjejë zgjidhjen më optimale që t'i ruajë marrëdhënet e mira me ShBA-në dhe BE-në, por edhe të krijojë mekanizëm të quartë që nuk i lejon epërsi Serbisë në dialog para se ta heqë taksën. Ideja e pezullimit të taksës mund të ishte një zgjidhje e tillë e balancuar. Sa i takon reciprocitetit, e shoh si masë vështirë të aplikueshme në të gjitha aspektet e saj", ka thënë Gashi.

Ai ka bërë me dije se edhe në raport me dialogun Kosovë - Serbi, Kosova duhet t'i ndjekë sugjerimet e miqve të vet perëndimorë. "Unë jam i prirë që rolin e z. Grenel ta shoh si rol të ShBA-së. Nëse ky është një fakt i mirëqenë, atëherë Kosova duhet ta shohë më sy optimist si një përshpejtues të procesit të dialogut përritjet e një marrëveshje përfundimtare Kosovë - Serbi që i hap rrugë edhe njohjes nga Serbia. Ne duhet, sikurse në Rambuje dhe në Vjenë, edhe tanë duhet t'i ndjekim sugjerimet që vijnë nga Washingtoni dhe nga Brukseli", ka vlerësuar ai.

Gashi ka folur edhe për objektivat që qeveria e re duhet t'i ketë në politikën e jashtme. Sipas tij, edhe funksionimi i mirëfilltë dhe i qëndrueshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe i shërbimit diplomatik duhet



të jetë një prioritet i qeverisë. "Më genë më i saktë, duhet të bëhet më efikas komunikimi institucional midis MPJ-së dhe misioneve tona diplomatike. Shpeshherë ky komunikim nuk ka qenë në nivelin që kërkohet të jetë, qoftë edhe referuar konventave të Vjenës përritjet e marrëdhënie diplomatike dhe përritjet e marrëdhënie konsullore", ka thënë Gashi.

"Epoka e re": Z. Gashi, si e vlerësoni pozitën aktuale ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, sepse ka vlerësimë se ajo është dëmtuar kohët e fundit?

Gashi: Sigurisht pozita ndërkombëtare e Kosovës që nga shpallja e pavarësisë nuk ka qenë shumë e volitshme përritjet e mosnjohjes së pavarësisë tash e 12 vjet nga një komunitet relativisht i madh i shteteve. Kur i shton kësaj

edhe vështirësitë dhe sfidat e brendshme në konsolidimin e shtetit kjo e bën edhe më të pafavorishme pozitën ndërkombëtare të Kosovës, sepse një shtet i pazhvilluar ekonomikisht, më shkallë të lartë të papunësisë, me shkallë të ulët të investimeve të huaja, me bilanc tepër negativ tregtar, me nivel të lartë të korruptionit nuk merret shumë seriozisht përritjet e mos thënë

shihet me mosbesim në planin ndërkombëtar.

"Epoka e re": Meqenëse tanë kemi një qeveri të re, cilat duhet të janë objektivat kryesore të saj në politikën e jashtme?

Gashi: Sigurisht qeveria e re duhet të ketë objektiva të qarta programore për trajtimin e problemeve që shteti ynë ka përpëra në planin ndërkombëtar.



hte zgjidhje e balancuar

Por, jo vetëm kaq. Edhe funksionimi i mirëfilltë dhe i qëndrueshëm i MPJ-së dhe i shërbimit diplomatik duhet të jetë një prioritet i qeverisë. Me qenë më i saktë, duhet të behët më efikas komunikimi institucional midis MPJ-së dhe misioneve tonë diplomatike. Shpeshherë ky komunikim nuk ka qenë në nivelin që kërkohet të jetë, qoftë edhe referuar Konventave të Vjenës për marrëdhënie diplomatike dhe për marrëdhënie konsullore.

“Epoka e re”: Vitet e fundit Kosova është përballur me një ofensivë diplomatike të Serbisë për heqjen e njohjeve dhe pengimin e Kosovës për në organizata ndërkombëtare. Si duhet t'i përgjigjet Kosova kësaj?

Gashi: Punë më e madhe me shtetet mike, diplomaci më aktive dhe më eficiente, ruajtje dhe forcim i marrëdhënieve me të gjitha shtetet e tjera që e kanë njojur pavarësinë e Kosovës. Diplomaci ekonomike dhe kulturore më intensive dhe, mbi të gjitha, lobim më i konsoliduar dhe më i koordinuar me ShBA-në dhe vendet e fuqishme mike të BE-së.

“Epoka e re”: Qeveria e re po përballet me një presion ndërkomëtar për ta hequr taksën ndaj mallrave serbe në mënyrë që të rifillojë dialogu Kosovë - Serbi, ndërsa qeveria ka paralajmëruar zëvendësimin e saj me reciprocitet. A duhet ta dëgjojë Kosova këshillën e ShBA-së dhe të BE-së?

Gashi: Qeveria e re duhet ta gjejë zgjidhjen më optimale që t'i ruajë marrëdhëniet e mira me ShBA-në dhe BE-në, por edhe të krijojë mekanizëm të qartë që nuk i lejon epërsi Serbisë në dialog, para se ta heqë taksën. Ideja e pezullimit të taksës mund të ishte një zgjidhje e tillë e balancuar. Sa i takon reciprocitetit, e shoh si masë vështirë të aplikueshme në të gjitha aspektet e saj.

"Epoka e re": Përfaqësuesi special i presidentit amerikan për dialogun, z. Grenell, ka marrë një rol shumë aktiv në dialogun Kosovë - Serbi. Si e shihni rolin e tij në këtë proces?

Ne ende nuk e kemi parë një program qeverisës që të mund të themi ndonjë vlerësim për të, qoftë edhe për politikën e jashtme. Dialogu më Serbinë, me synim të quartë arritjen e njohjes nga Serbia, lobimi për arritjen e njohjeve të reja, anëtarësimi në organizatat shumëpalëshe, si dhe synimi final anëtarësimi në OKB, do të duhej të ishin objektivat proprietare të qeverisës në politikën e jashtme.

Gashi: Unë jam i prirë që rolin e z. Grenel ta shohë si rol të ShBA-së. Nëse ky është një fakt i mirëqenë, atëherë Kosova duhet ta shohë me sy optimist si një përshtypjetues të procesit të dialogut për arritjen e një marrëveshje përfundimtare Kosovë - Serbi që i hap rrugë edhe njohjes nga Serbia. Ne duhet, sikurse në Rambuje dhe në Vjenë, edhe tani t'i ndjekim sugjerimet që vijnë nga Uashingtoni dhe nga Brukseli.



Përurohet laboratori i mikrobiologjisë në Klinikën Infektive

EPOKA | 10 | DÜZGÜNLÜK

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 SHKURT - Në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës të hënën u përruua laboratori modern i mikrobiologjisë, i bërë me fondet e projektit “Mbështetje për sistemin shëndetësor të Kosovës” nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim. Në këtë ceremoni morën pjesë drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, dhe ambasadori i Italisë në Kosovë, Nicola Gallo.

Ministri Vitia ka theksuar se përrurimi i këtij laboratori është një tregues i qartë se ky projekt italiane po iep. rezultata të drejtë

tanai po jep rezultate të drejtpërdrejta për fuqizimin e kapaciteteve të institucioneve shëndetësore të Kosovës, për t'u ballafaquar me sfida serioze të shëndetit publik, siç janë edhe infekzionet spitalore dhe rezistenca antimikrobike. "Ministria e Shëndetësisë ka aprovuar vitin që shkoi planin strategjik përezistencën antimikrobike 2019-2021 si dhe ka nxjerrë vendimin për themelimin e Grupit Ndërsektorial për Kontrollin e Rezistencës Antimikrobike (GNKRA), i cili është përgjegjës për zbatimin e planit të veprimit. Në zbatim të këtij plani të veprimit që pëfshin gjithsej 47 aktivitete të parapara për t'u realizuar për tri vjet, 26 prej këtyre aktivitetave

mbështeten nga AICS, në mesin e të cilave edhe aktiviteti që po realizohet sot me përrimin e laboratorit klinik të Mikrobiologjisë", ka theksuar ai. Sipas tij, Ministria e Shëndetësisë do të jetë në nivel të përgjegjësisë që i takon, duke mbështetur institucionet në adresimin e çdo problemi të shëndetit publik dhe, njëkohësisht, duke mbajtur partneritetin serioz me të gjithë kontributorët në shëndetësi siç është edhe ky investim i përruruar sot.

Në fund, ministri Vitia ka shprehur besimin e tij se pajisjet e reja të përdoren, ruhen e mirëmbahen me kujdes, në mënyrë që t'i shërbejnë përmirësimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe ngritjes së cilësisë së tyre. Ai ka falënderuar Agjencinë Italiane për

Bashkëpunim dhe Zhvillim për investimin e bërë. Ndërsa ambasadori italian, Nicola Orlando, ka thënë se Italia do të jetë përkrah Kosovës. “Gjendemi para sfidave që nuk kanë kufij. Italia është në linjën e parë që përballet me këto sfida. Italia do të jetë afér partnerëve të saj, në këtë rast Kosovës. Ky projekt që pamë sot është punë dhjetëvjeçare e Agjencisë për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Kosovë”, ka thënë ambasadori Orlando.

Ai ka shtuar se janë shumë të kënaqur me kapacitetin dhe vullnetin e punëtorëve shëndetësorë të Kosovës. Duke e falën-deruar për investimin e bërë, drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka ndarë një mirënjojje për ambasadorin italian dhe Agjencinë për Zhvillim dhe Bashkëpunim.



Ambasadori Dinosha kërkon që komuniteti malazez të integrohet në kuadër të FSK-së

PRISHTINË, 24 SHKURT (ER) - Në vazhdën e vizitave të ambasadorëve të vendeve mike, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, ka pritur të hënën ambasadorin e Malit të Zi në Kosovë, Ferhat Dinosha, i cili ka uruar ministrin Quni për pozitën e re. Ai në fjalën e tij përcollti zotimin e autoriteteve shtetërore të Malit të Zi për vazhdimin e bashkëpunimit bilateral dhe mbështetjen e Kosovës në rrugën e integrimit evropian dhe euroatlantik në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes si vend fqinj dhe miqësor. Ambasadori Dinosha ka

shprehur interesimin për integrimin e mëtejmë të pjesëtarëve nga radhët e komunitetit malazez në kuadër të integrimit të pjesëtarëve nga radhët e të gjitha komunitetave të tjera joshumicë në Kosovë. Duke i uruar mirëseardhje, ministri Quni ka shprehur vlerësimin e lartë për bashkëpunimin e deritashëm bilateral me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Malit të Zi me interesimin për shtimin e mëtejmë të këtij bashkëpunimi në fushat e interesit të përbashkët në funksion të paqes, stabilitetit dhe sigurisë rajonale dhe më gjérë. Lidhur me çështjen e integrimit të pjesëtarëve nga radhët e komunitetit malazez, ministri Quni ka theksuar se FSK-ja është institucion i të gjithëve dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve të vendit, pa dallime etnike, racore, gjinore e fetare, dhe se pjesëtarët e komunitetit malazez, sikur edhe pjesëtarët e tjerë nga komunitetet e tjera joshumicë, janë të mirëpritur të inkuadrohen në radhët e FSK-së dhe ta jepin kontributin e tyre në shërbim për të mirën e përbashkët.



Sveçla: Bashkëpunimi rajonal ndihmon mbikëqyrjen demokratike të sektorit të sigurisë



PRISHTINË, 24 SHKURT (ER) - Zëvendësministri i parë i Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Xhelal Sveçla, ka pritur të hënën në takim një delegacion të udhëhequr nga Merijn Hartog, drejtor i Qendrës për Studime të Sigurisë Evropiane, i shoqëruar nga Peter Vanhoutte dhe Lulzim Peci, drejtor ekzekutiv i Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave. Ky takim është zhvilluar me qëllim të diskutimit të projektit "Zhvillimi i kapacitetave, bashkëpunimit dhe kulturës së mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë Veriore (DECOS)". Projekti në fjalë ka për qëllim t'i fuqizojë parlamentet, organizatat e shoqërisë civile dhe rolin e tyre në mbikëqyrjen demokratike të sektorit të sigurisë. Në këtë takim u bë me dije se me anë të këtij projekti do të ngritën kapacitetet dhe do të rritet bashkëpunimi i mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe në Maqedoninë Veriore.

Zvicra do të vazhdojë ta mbështesë arsimin në Kosovë

PRISHTINË, 24 SHKURT (ER) - Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Hykmete Bajrami, ka pritur të hënën ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Jean-Hubert Lebet, me të cilin ka biseduar për gjendjen në fushën e arsimit dhe programin e Qeverisë së Kosovës për ta përmirësuar këtë gjendje. Ambasadori Jean-Hubert Lebet i ka uruar ministres Bajrami detyrën, ndërsa ka theksuar se Zvicra do të vazhdojë ta

mbështesë arsimin në Kosovë, respektivisht implementimin e programit qeveritar për arsimin.

Ministrja Bajrami ka falënderuar ambasadorin për mbështetjen që Zvicra ka dhënë ndër vite në të gjitha fushat e jetës në Kosovë, në veçanti në sektorin e arsimit. Ajo ka theksuar rëndësinë e mbështetjes së mëtutjeshme në mënyrë që të realizohet misioni për ndryshime pozitive në të gjitha nivelet e arsimit.



UP-ja ndan mbi 1 000 bursa për studentët

PRISHTINË, 24 SHKURT (ER) - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" do të ndajë 1 052 bursa për studentët për vitin akademik 2019-2020. Sipas një njoftimi për media të UP-së, Këshilli Drejtues i Universitetit

ka aprovuar më 20 shkurt raportin e Komisionit për Ndarje të Bursave Universitare për Studentët e UP-së për vitin akademik 2019-2020. Secili nga studentët do të përfitojë nga Universiteti 650 euro. Më së shumti bursa do të ndahen për studentët e Fakultetit Juridik (193). Me mbi 100 bursa janë edhe studentët e Fakultetit të Arteve (137), Mjekësisë (125) dhe Ekonomik (114).



Në Kosovë nuk ka të prekur nga koronavirusi

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka bërë me dije se në Kosovë nuk ka njerëz të prekur me koronavirus. Përmes një komunikatë për media ky institut treguar se ka marrë informatë nga Klinika Infektive e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për një paciente që dyshohej se ishte e prekur me koronavirus por që, pas testimit, ajo ka dalë negative

EPOKA
ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 SHKURT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) ka marrë informatë nga Klinika Infektive e QKUK-së për një paciente të dyshimtë me sëmundjen koronavirus COCID-19. "Pacientja ka pasur ethe, djegjeje të syve, rrjedhje hunde dhe fytin e ndjeshëm. Ekipi i Laboratorit të Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK ka bërë testimin në virusin SARS-CoV-2 me metodën rRT-PCR. Testi ka rezultuar negativ, domethënë pacientja nuk është infektuar me virusin SARS-CoV-2", është thënë në njoftimin e IKSHPK-së.

Në këtë njoftim është theksuar se laboratori mikrobiologjik/IKSHPK është pajisur me kite dhe reagensa për detektimin e 2019-nCoV. "Ekipet e Institutit Kombëtar po përcjellin me vëmendje situatën epidemiologjike me koronavirus në botë. Komiteti për monitorimin e sëmundjeve ngjitime ka konstatuar se janë përfocuar masat për monitorimin, parandalimin e rrezikut të përhapjes së koronavirusit të ri", është thënë në njoftimin për media, duke theksuar tutje se është kompletuar plani gatishmërisë për koronavirus dhe plani i kontingjencës duke iu përbajtj strikt rekondimeve të OBSh-së. "Janë shpërndarë materialet dhe dokumentet,



posteret e shtypur nga Instituti Kombëtar me kohë janë shpërndarë në institucionet shëndetësore, shkolla, aeroport, hyrje/daljet tokësore, institucionet e burgjeve. Komunikimi me media

dhe rrjetet sociale është në vazhdimësi për ta ruajtur panikun e mundshëm. Është bërë ngritja e nivelit të vigilencës dhe gatishmërisë për veprim në situatën e krijuar 24 orë në ANP

'Adem Jashari' dhe në hyrje-daljet e Kosovës me ekipe mjekësore. Të gjitha institucionet shëndetësore janë të përgatitura për përballje me shfaqjen e sëmundjes", është theksuar në njoftimin e IKShPK-së.

Demokracia Plus (D+) mbajti tryezë për dyfishimin e pozitave të nëpunësve civilë

Demokracia Plus: Asnjë nëpunësi civil në vend nuk duhet t'i shkëputet kontrata

Demokracia Plus (D+) ka mbajtur të hënën tryezë lidhur me dyfishimin e pozitave të nëpunësve civilë si rezultat i ristrukturimit të qeverisë nga 21 në 15 ministri. Në këtë tryezë u tha se asnjë nëpunësi civil në vend nuk duhet t'i shkëputet kontrata, pavarësish se të njëjtit nuk punojnë në ministritë ku ishin më herët dhe se qeveria duhet t'i risistemojë ata në ministritë përkatëse ku edhe janë bashkuar së fundmi, në të kundërtën largimi i tyre nga puna do të jetë i paligjshëm

EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 SHKURT - Demokracia Plus (D+) ka mbajtur të hënën tryezë lidhur me dyfishimin e pozitave të nëpunësve civilë si rezultat i ristrukturimit të qeverisë nga 21 në 15 ministri, në të cilën morën pjesë përfaqësues të ministrive të ndryshme, të komisionit për qeverisje lokale, administratë publike, zhvillim rajonal dhe të shoqërisë civile. Në këtë tryezë u tha se asnjë nëpunësi civil në vend nuk duhet t'i shkëputet kontrata, pavarësish se të njëjtit nuk punojnë në ministritë ku ishin më herët dhe se qeveria

duhet t'i risistemojë ata në ministritë përkatëse ku edhe janë bashkuar së fundmi, në të kundërtën largimi i tyre nga puna do të jetë i paligjshëm. Visar Rushiti, analist i politikave në D+, tha se nëse qeveria dëshiron ta zvogëlojë numrin e nëpunësve civilë atëherë, sipas tij, një propozim është që të ndalojë rekrutimin derisa të dihet se ku do të risistemohen këta të fundit.

Valon Ramadani, anëtar i Komisionit për Qeverisje Lokale, Administratë Publike, Zhvillim Rajonal, ka thënë se për t'u përmirësuar kjo gjendje është e domosdoshme që të reformohet administrata. Vuri në pah



nevojën e shtimit të inspektorëve nga 60 sa janë tani në 400. Ekzistonjë një numër i pozitave të nëpunësve civilë të cilat janë të njëjta në se cilëën ministri, p. sh., pozita e sekretarit të përgjithshëm, pozita e drejtoret të Departamentit Ligjor, drejtoret të Departamentit për Integrimë Evropiane dhe Koordinim të Politikave, udhëheqësit të personelit, auditorit të brendshëm, udhëheqësit të

prokurimit, udhëheqësit të komunikimit publik dhe një numër të pozitave të shërbyesve civilë të kategorisë profesionale si, p. sh., zyrtar certifikues, zyrtar shpenzues, zyrtar përbuxhet dhe financa etj. Siç dihet, të gjithë nëpunësit civilë me kontrata të rregullta pune kanë akt emërimë me afat të pacaktuar. Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil njeh dhe trajton kategorinë e nëpunësve

civilë tepricë në rast të suprimimit, bashkimit apo riorganizimit të institucionit (Neni 32 i ligjit përkatës). Në anën tjeter, Ligji nr. 06/L-114 i cili është i pezulluar nga Gjykata Kushtetuese deri në fund të shkurtit 2020 njeh të drejtën e transferimit të nëpunësve civilë për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit në një pozitë tjeter të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori (Neni 54).

Prokuroria në Prizren ngre aktakuzë për fajde ndaj tre personave

PRISHTINË, 24 SHKURT (ER) -
Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve me inicialet I. M. dhe M. M. për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprat penale "Fajdeja" si dhe për veprën penale "Detyrim në tentativë". Sipas aktakuzës, i pandehuri I. M. gjatë muajit maj të vitit 2019, në fshatin Krushë e Vogël dhe në Prizren, në vazhdimesi me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete, ka kontraktuar një shumë dukshëm joproportionale të pasurisë në këmbim të shërbimit (dhënies së borxhit), duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të të dëmtuarit B. Q. "Në atë mënyrë, për dhënien e një borxhi fillimisht në shumë prej 3 000 eurosh, ka kontraktuar normë mujore të interesit prej 25 përqindësh, e të cilin interes i dëmtuari ka paguar për katër muaj radhazi, në shumë të përgjithshme prej 3 000 eurosh dhe më pas në muajin shtator të po këtij viti ka kontraktuar edhe borxhe të tjera prej 4 000 eurosh, 7 000 eurosh, 5 000 eurosh, 13 000 eurosh dhe 5 000 eurosh me normë mujore të interesit prej 15 përqindësh, të cilin interes i dëmtuari ka qenë i detyruar ta paguajë në dy këste. Më 5 dhe 15 të çdo muaji pasues, për të cilat shuma i dëmtuari ka paguar për dy muaj shumën prej 6 100 eurosh, i cili për borxhin e marrë në shumë totale prej 37 000 eurosh ka paguar interes në vlerë të përgjithshme prej 15 200

eurosh. Me këto veprime i pandehuri I. M. ka kryer vepër penale 'Fajdeja' sipas KPRK-së", thuhet në njoftim. Njoftohet, po ashtu, se i pandehuri I. M. gjatë periudhës kohore 05.12.2019 - 16.12.2019, me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale - 'Detyrim', por vepra penale si e tillë mbetet në tentativë. "I pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete përdorë kanosjen serioze në mënyrë permanente ndaj të dëmtuarit B. Q., për ta detyruar këtë të fundit të kryejë veprim në dëm të pasurisë së tij dhe atë duke e kanosur me qëllim të realizimit të përfitimit nga kontraktimi i shumës dukshëm joproportionale. Me këto veprime i pandehuri ka kryer veprën penale 'Detyrim në tentativë' sipas KPRK-së", thuhet tutje në njoftim.

Ndërkaq i pandehuri M. M. gjatë muajit maj të vitit 2019 në fshatin Krushë e Vogël dhe në Prizren, në vazhdimësi, me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete, ka kontraktuar një shumë dukshëm joproportionale të pasurisë në këmbim të shërbimit (dhënes së borxhit), duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të dëmtuarit B. Q. "Fillimisht kontrakton në emër të borxhit shumën prej 5 000 eurosh me normë mujore të interesit prej 25 përqindësh, të cilin interes i dëmtuari e ka paguar për shtatë muaj radhazi, në shumë të përgjithshme prej 8 750 eurosh. Pastaj sërisht në

muajin shtator kontrakton me
të dëmtuarin borxhin tjetër në
shumë prej 5 000 eurosh, me
normë mujore të interesit prej
25 përqindësh, të cilën normë
mujore të interesit ka qenë
detyruar të paguajë me 7 të çdo
muaji pasues dhe këtë e ka bërë
për dy muaj radhazi, duke
paguar normë mujore të
interesit shumën prej 1 250
eurosh, gjegjësisht për dy muaj
ka paguar 2 500 euro dhe pë
shumën e tërësishme të
kontraktuar për borxh, i
dëmtuari ka paguar interes në
vlerë të përgjithshme prej 11 250
eurosh", ka njoftuar Prokuroria
Themelore në Prizren.

Me këto veprime i pandehuri ka kryer veprën penale "Fajdeja" sipas KPRK-së. "Po ashtu, i pandehuri M. M. gjatë periudhës kohore 07.12.2019 - 16.12.2019, me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale - detyrim, por vepra penale si e tillë mbetet në tentativë, në atë mënyrë që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, përdorë kanosjen serioze në mënyrë permanente ndaj të démtuarit B. Q., për ta detyruar këtë të fundit të kryej veprim në dëm të pasurisë së tij dhe atë duke e

kanosur me qëllim të realizimit
të përfitimit nga kontraktimi i
shumës dukshëm
joproportionale në atë mënyrë
që gjatë takimeve me të të
dëmtuarin në Prizren, e kanos.
Me këto veprime ka kryer
veprën penale ‘Detyrimi në
tentativë’ sipas KPRK-së”,
thuhet tutje në njoftimin e
Prokurorisë Themelore në
Prizren.

Prokurori i çështjes me rastin e
ngritjes së aktakuzës i ka
propozuar gjykatës që të
pandehurit të shpallen fajtorë
dhe të dënohen sipas ligjit për
veprat penale të cilat u vihen në
barrë



Më 1 mars në Gjermani hyn në fuqi Ligji përfuqinë punëtore të kualifikuar

PRISHTINË 24 SHKURT (ER) - Më 1 mars në Gjermani pritet të hyjë në fuqi Ligji për Fuqinë Punëtore të Kualifikuar, i cili rregullon në detaje ardhjen e tyre nga vendet jashtë Bashkimit Evropian. Sipas ligjit, për herë të parë mund të shkosh në Gjermani edhe me një vizë gjashtëmuajore për të kërkuar punë duke i mbuluar personalisht shpenzimet për këtë periudhë.

jetesën në këtë kohë. Ambasada Gjermane në Prishtinë me anë të një njoftimi ka treguar disa nga detajet e këtij ligji dhe procedurën e aplikimit për vizë. "Si fuqi punëtore e kualifikuar konsiderohen të diplomuarit në universitete si dhe personat me një kualifikim në arsimin profesional që njihet në Gjermani. Punësimi është i mundur vetëm në atë profesion për të cilin keni marrë më parë kualifikimin përkatës. Një diplomë profesionale konsiderohet zakonisht si e kualifikuar dhe njihet, nëse në Gjermani ajo do të merrej pas një periudhe dy-tre-vjeçare të arsimit profesional", thuhet në njoftimin e Ambasadës së Gjermanisë



AAK-ja: Taksa nuk duhet të hiqet deri në njohjen reciproke



Taksa 100 për qind ndaj Serbisë ka rritur prodhimtarinë e produkteve vendore dhe numrin e të punësuarve dhe se Kosova duhet ta përdorë taksën si pjesë e njohjes reciproke me Serbinë. Kështu u konstatua në tryezën e organizuar nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 24 SHKURT - Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ka organizuar të hënën tryezë për taksën 100 për qind ndaj produkteve nga Serbia dhe Bosnja. Në këtë tryezë u konstatua se taksa 100 për qind ndaj Serbisë ka rritur prodhimtarinë e produkteve vendore dhe numrin e të punësuarve në Kosovë dhe se

Kosova duhet ta përdorë taksën si pjesë e njohjes reciproke me Serbinë.

Deputeti Gazmend Abrashi, derisa ka paraqitur arsyet e mbajtjes së taksës, ka thënë se qeveria e re nuk duhet ta largojë atë deri në njohjen reciproke ndërmjet dy shteteve. "Vendosja e tarifës ishte instrument i vetëm me të cilën do të reagon Kosova ndaj veprimeve desktruktive të Serbisë. Kemi rritje të dukshme të numrit të punësuarve. 67 për

qind e bizneseve kanë deklaruar se janë rritur shitjet pas vendosjes së tarifës, deri 33 për qind kanë deklaruar se shitjet kanë mbetur të njëjtë. Nga analiza që është bërë nga Aleanca Kosovare e Bizneseve, në pyetjen për ndikimin e taksës 50 për qind janë përgjigjur pozitivisht, 15 neutral, 35 për qind negativisht. Serbia pas vendosjes së tarifës përmes kontrollit medial tentoi ta minimizojë këtë hap me arsyen se kjo nuk do të ndikojë

në ekonominë e saj, por me kalimin e kohës Serbia është dorëzuar dhe kërkoi heqjen e taksës", ka thënë ai.

Ndërsa që është bërë nga Aleanca Kosovare e Bizneseve, në pyetjen për ndikimin e taksës 50 për qind janë përgjigjur pozitivisht, 15 neutral, 35 për qind negativisht. Serbia pas vendosjes së tarifës përmes kontrollit medial tentoi ta minimizojë këtë hap me arsyen se kjo nuk do të ndikojë

potencialin ekonomik", është shprehur ai.

Agim Shahini, kryetar i AKB-së, ka deklaruar se taksa, përvëç aspektit ekonomik, ka ndikuar edhe në vetëdijesimin e qytetarëve për të konsumuar produkte vendëse. "Aleanca Kosovare e Biznesit e ka vlerësuar taksën si asset ekonomik dhe diplomatik. Efekti i taksës ka rritur 100 milionë ekonominë e Kosovës, por ka rritur edhe vetëdijesimin e qytetarëve për të konsumuar produkte vendore. AKB-ja gjithmonë do të jetë me bizneset që ne flasim në emër të tyre", u shpreh ai.

Ndërsa Hil Dulaj nga një kompani farmaceutike ka thënë se taksa ndaj Serbisë ka ngritur prodhimin vendor.

Alban Zogaj emërohet shef i kabinetit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit

PRISHTINË, 24 SHKURT (ER) - Alban Zogaj është emëruar shef i kabinetit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit. Ministri Abdixiku ka bërë me dije se Zogaj e ka të përfunduar magjistraturën në Britani të Madhe e doktoraturën për ekonomi në Itali. "Është i specializuar në politikat makroekonomike, ekonomiksin e zhvillimit, politikat industriale, financat publike e në menaxhment. Ka të publikuara një sërë punimesh ekonomike në revistat më prestigjioze ndërkombëtare. Së fundmi ishte

ekonomist kryesor në organizatën prestigjioze amerikane MCC, zyra në Kosovë. Si ekspert i ekonomisë, si ligjërues universitar, si menaxhues i jashtëzakonshëm, Albani me përvojën 15-vjeçare në projekte brenda e jashtë vendit do t'i sjellë ekipit tim koordinimin e energjinë e domosdoshme. Vlerat e tij të punës, etika e dija që në vete bartë ai, do të jenë asete përgjithë ekipin tim: për ministrinë, shoqërinë e Republikën", ka shkruar Abdixiku në llogarinë e vet në "Facebook". Po ashtu, ministri i

Infrastrukturës dhe Ambientit, Lumir Abdixiku, të hënën ka pritur në takim ambasadoren e Kroacisë në Kosovë, Danijela Barishi.

Në takimin njoftues, ministri Abdixiku ka shpalosur planin qeverisës për infrastrukturë dhe ambient, në veçanti projektet me prioritet për të cilat janë angazhuar për implementimin e tyre me marrjen e mandatit. Ambasadorja Barishi, krahas urimit për marrjen e detyrës së ministrit, Abdixikut i shprehu gatishmërinë për ta ofruar mbështetjen e nevojshme.



Komuna e Prishtinës kërkon që të respektohen lejet e ndërtimit

PRISHTINË, 24 SHKURT (ER) - Drejtoria e Inspeksionit në Komunën e Prishtinës, Sektori i Ndërtimit, ka evidentuar tejkalime të lejeve ndërtimore në dy raste të ngashme në rrugën "Musa Tolaj". Sipas njoftimit të kësaj komune, me kohë janë ndërmarrë të gjitha veprimet nga ana e inspektorëve përgjegjës, që nga vendimet e ndërprenjes e deri te

vendimet e rrënimit, vendime këto që nuk janë respektuar nga palët. "Kësisoj, sot kemi filluar rrënimin e pjesëve të ndërtuara pa leje, në të dyja rastet në të njëjtën kohë. U bëjmë thirrje të gjithë investitorëve që t'i respektojnë në tërësi lejet ndërtimore, në të kundërtën rrënimi është i pashmangshëm", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



Komuna e Kaçanikut ndan 50 bursa për studentët kaçanikas

KAÇANIK, 24 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, ka bërë me dije se nga buxheti komunal për vitin 2020 ka ndarë 20 mijë euro për bursa studentore. Në mbledhjen e fillimjavës të ekzekutivit komunal, Drejtoria për Arsim

dhe Kulturë në Kaçanik ka njoftuar se tashmë është hapur konkursi për të gjithë studentët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara. Sipas kësaj drejtorie, 50 studentë do të përfitojnë bursa. "Ndarja e bursave studentore tashmë është bërë traditë në qeverisjen lokale, ku

ndër vite shumë studentë kaçanikas kanë përfituar nga këto bursa të cilat sadopak kanë lehtësuar barrën studentore, ndërsa ky subvencionim po bëhet me qëllim të përkrahjes së shkollimit të të rinjve", ka njoftuar Komuna e Kaçanikut.



Komuna e Podujevës rikonfirmon bashkëpunimin me Bashkësinë Islame

PODUJEVË, 24 SHKURT (ER) - Nënkyryetari i Komunës së Podujevës, Nexhami Rudari, ka vizituat të hënën Këshillin e Bashkësisë Islame në këtë komunë për ta uruar kryetarin e porsazgjedhur të këtij institucioni, Mensur Hoti.

Gjatë vizitës në Këshillin e Bashkësisë Islame në Podujevë, ku ishin edhe anëtarë të ekzekutivit të komunës, nënkyryetari Rudari ka thënë se kjo komunë ka

një traditë të shkëlqyeshme të bashkëpunimit me këtë institucion të rëndësishëm fetar. Nënkyryetari Rudari gjatë këtij takimi ka rikonfirmuar gatishmërinë e komunës për t'i vazhduar projektet e përbashkëta. "Prijësit fetarë llapjanë kanë luajtur rol të rëndësishëm në të gjitha proceset, veçmash vitet e fundit. Prandaj gjithmonë do ta kenë mbështetjen e Komunës së Podujevës", ka thënë Rudari.



Vazhdojnë vizitat nëpër institucionet shëndetësore në Suharekë

SUHAREKË, 24 SHKURT (ER) - Komuna e Suharekës ka njoftuar se janë duke vazhduar vizitat nëpër Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe në Ambulancat Mjekësore Familjare (AMF).

Sipas njoftimit të kësaj komune, nënkyryetarja Mihrije Suka dhe dretoresha e Shëndetësisë, dr. Sale Bytyqi, kanë vizituat këto institucionë shëndetësore për ta parë gjendjen nga afér

dhe se si kalohet një ditë pune në QMF dhe AMF. "Vizitat janë bërë në Studençan, Doberdelan, Samadrexhë dhe Greikoc", ka njoftuar Komuna e Suharekës.



Edukimi medial

Mësimi nga Xhamajka dhe Hoti



Milazim KRASNIQI

Histerizmi llumpenproletarist lidhur me Xhamajkën, me ç'rast kërkoheshin dorëheqje e ndëshkime, tërësish u zëvendësua nga histerizmi po ashtu llumpenproletarist i radhës, si reagim ndaj sulmit me vezë ndaj Avdullah Hotit. Realisht, këto dy ngjarje nuk

kanë asnjë lidhje njëra me tjetrën. Të vetmen lidhje e kanë që të dyja raportohen, pompojen, komentojen dhe propagandohen në media dhe bëhen "arena lufte" të kotsidashësve. Në fakt, mediat ua jepin edhe këtyre dy ngjarjeve rëndësinë dhe vlerat që realisht nuk i kanë. Fjala vjen, mosnjohja e Kosovës nga Xhamajka në realitet nuk është kurfarë ngjarjeje e as kurfarë lajmi. Kosova mund të ekzistojë deri në Ditën e Kiametit, pa u varë me asnjë nga Xhamajka. Po ashtu, Avdullah Hoti nuk ka pësuar ndonjë lëndim, vazhdon të jetë zëvendëskryeministër, pa pasur asnjë pasojë në shëndet e në karrierë. Prandaj, në të dyja

rastet e raportuara si ngjarje, kotsidashësit e kapur në karrem nga media janë ngjarja, jo Xhamajka e Hoti. Xhamajkën e bëri ngjarje një tjetër, të dytën një video amatore. Pastaj reagimet, histerizmat që i shoqëruan si këlbaza pas një kolle, u bënë vetë "ngjarje".

Është me interes të dimë se kush janë këta njerëz që reagojnë, lavdërohen, fyejnë, kërkojnë përgjegjësi, shkumojnë, pa pasur asnjë kompetencë, pa pasur asnjë dije politike, pa pasur asnjë kredi morale? Ndoshta n rastin e Xhamajkës i përfaqëson më së miri deputetja F.P., kur tha se era e ndryshimeve që u bënë në Kosovë, u ndie në Xhamajka!

Pra, ajo në këtë rast rezulton si simbol i njerëzve që flasin kuturu, pa përgjegjësi politike e morale. Kjo kategori komunikuesish kujton se e ka fituar lirinë e shprehjes, pa e pasur të qartë se më shumë e kanë fituar lirinë që të bëhen gazi i botës.

Po media a u ka faj këtyre njerëzve? Në fakt, media vetëm sa e bën punën e vet, në pajtim me natyrën e vet prej demoni, siç e emërtojnë disa teoricienë të njohur. Natyra e saj është t'i vë në lojë të shfrenuarit dhe injorantët. Ua jep mundësinë që të shpërrallohen. Ata luftojnë në media e rrjete sociale për gjëra që nuk i kanë në dorë, për të cilat nuk i pyet askush asnjë, prej

të cilave nuk varet asnjë në jetën e tyre. Pra, harxhojnë kohë e energji në punë të kota. Këshilla ime mësuesore është: ndaleni veten oj shpe! Merrni frymë, bre! Xhamajka është larg, Hoti është lart. Ju shikojeni veten, aty ku jeni dhe mundohuni ta kuptioni pse jeni aty ku jeni dhe përpinqi me punë ta përmirësoni gjendjen tuaj e jetën tuaj! As Xhamajka, as Hoti nuk mund t'u ndihmojnë, pa i ndihmuar ju vetes, të jeni të sigurt! As shkulmet histerike me komente në portale e në rrjete sociale, nuk u ndihmojnë asnjë. Vetëm ua shtojnë vetminë dhe mërzinë, duke u bartë nga një stres në tjeterin, pa asnjë nevojë, pa asnjë përfitim.

FSSh-ja ndan 30 000 euro për trajtimin mjekësor të Erion Haxhnikajt

PRISHTINË, 24 SHKURT (ER) - Fondi i Sigurimeve Shëndetësore (FSSH) ka lëshuar të hënën fletëzotimin përmblimin e shpenzimeve të trajtimit mjekësor të Erion Haxhnikajt jashtë institucioneve shëndetësore publike (Turqi, Koç University Hospital) në vlerën prej 30 000 eurove. Vendimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore është bazuar në raportin mjekësor të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) të datës 19 shkurt 2020, me ç'rast pacienti rekomandohet për trajtim emergjent mjekësor jashtë institacioneve shëndetësore publike. Fletëzotimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore është lëshuar në mbështetje të këtij udhëzimi, vendos Bordi Ekzekutiv i Fondit bazuar në raportin përfundimtar mjekësor dhe financiar të lëshuar nga institucioni hospitalizues. Fondi i Sigurimeve Shëndetësore zotohet për përbushje të obligimit financiar ndaj institucionit në momentin e përfundimit të procedurave administrative në bazë të fletëlëshimit dhe të faturës së shpenzimeve nga institucioni.



Arrestohen dy të dyshuar në Istog për vjedhje të mjeteve të punës

ISTOG, 24 SHKURT (ER) - Në Stacionin Policor në Istog më 21 shkurt është paraqitur një rast 'vjedhje' nga viktima i cili deklaron se në vendin e tij të punës i janë vjedhur

mjete të punës. Më 23 shkurt, rrëth orës 16:00, pas një hetimi paraprak, janë arrestuar të dyshuarit S. M. dhe F. B. Gjërat e vjedhura janë gjetur tek i dyshuar i

dytë dhe të njëjtat janë sekuestruar për tia kthyer pronarit. Të dyshuarit, pas intervistikimit, me urdhër të prokurorit ndalohen për 48 orë.

KU JETON ALI AHMETI



Ismet SYLEJMANI

Kjo dhe shumë pyetje të tjera të shkojnë ndërmend derisa mendon se ku dhe si jetojnë figurat e njohura dhe personalitetet e mëdha të botës njerëzore shqiptare dhe botërore!

Të gjithë udhëheqësit e mëdhenjë kanë të vecantat e tyre që i bëjnë të përmasave të lavdishme!

Eshtë e zakonshme të dëgjohet, se si një figurë e madhe, pasi të vendoset në fronin e udhëheqësit të e ndrrøjë edhe vendbanimin!

Por unë sot bëjë pyetjen për të gjithë shqiptarët kudo që janë!

Ku jeton Ali Ahmeti?

Ku e ka shtëpinë, dhe sa metra katrörë(m2), eshtë shtëpia e Tij?

A e ka shtëpinë në vendlindjen e Tij në fshat, apo është shpërngular si udhëheqësit e tjerë, për të jetuar më mirë dhe më moderne në qytet apo në kryeqytet?

Sa udhëton në ditë Ali Ahmeti për të shkuar në punë?

Të paktë janë veprimtarët e çështjes kombëtare e edhe më të paktë janë drejtuesit e lartë e Udhëheqësit e Mëdhenj të Kombit, që me kontributin e madh që kanë dhënë në jetën e tyre, janë ndarë në shumë pjesë të Atdheut brenda dhe jashtë tij! Udhëheqësi i popullit shqiptar Ali Ahmeti është i pashembullt, është i pa shoq!

Ai është i vetëm dhe nuk ka edhe një tjetër, pra është unikat!

Në jetën e Tij të bujshme ka jetuar përpos në rini në vendlindjen e Tij në Zajas të Kërçoves, edhe si studentë në konvikt e banesa private legale e ilegale në Prishtinë!

Një pjesë të shkurtë të jetës e ka jetuar në burg në Kosovë, kur ishte i burgosur pas demonstratave të vitit 1981 në Prishtinë!

Pas daljes nga burgu dhe pas largimit ilegalisht nga ish-Jugosllavia, ka jetuar në Lucern të Zvicrës!

Pas përfundimit të luftës dhe çlirimt të Kosovës, derisa ka filluar lufta e UÇK-së në Maqedoninë e Veriut, ka jetuar në Kosovë e herëpasëherë ka udhëtar në Lucern në Zvicer!

Pas përfundimit të luftës së vitit 2001, në fillim ka jetuar në Selinë e Shtabit të Përgjithshëm në Shipkovicë!

Nga Selia e Shtabit të Përgjithshëm, përfundimisht jetën e Tij e ka vazhduar në vendlindjen e Tij në Zajaz të



Kërçovës!

Mijëra e miliona kilometra që ka kaluar, kalon e do të kalojë çdo ditë, me veturën dhe shoqërueshit e Tij edhe në të ardhmen, Udhëheqësi i popullit shqiptar Ali Ahmeti, në relacionin Zajas-Tetovë-Shkup dhe anasjelltas 130 km minimumi, janë e do të janë dëshmi se politika e madhe, reale dhe e sukseshme, nuk bëhet patjetër e domosdoshmërisht, nga qytetet e kryeqyteti, e vilat e mëdha shumëkatëshe e marramendëse për nga saltanati e lloksi i tepruar në kuriz të tak sapaguesve e shtetit, por është e mundshme edhe nga fshati e nga shtëpi të thjeshta e tradicionale shqiptare!

Ali Ahmeti nuk disponon me patentë shoferi! Pra le ta dijnë të gjithë se Lideri i madh shqiptar nuk disponon me leje për drejtim të veturës!

Nuk i është nënshtuar këtij provimi! Ka hequr dorë me vetëdije nga një argument i madh për të jetuar

me lloks jetën personale!

Por ka dhënë provimin e luftës për liri dhe ka patentën e drejtimit të popullit shqiptar! Edhe kjo është një tjetër dëshmi, se ky është prej atyre që e kishte të ndarë mendjen, të drejtonte vendin, popullin, Atdheun dhe Kombin, e jo veturën!

Se me kohë ishte përcaktuar që të ishte vetëm në sherbim të kauzës së shenjtë të popullit e Atdheut, të vendit e të mirëqenies së përgjithëshme dhe jo të jetës së tij individuale!

Ali Ahmeti edhe me jeten e Tij, jep shembullin e madh se guri i rëndë jo vetëm peshon në vend të vetin, por politika kombëtare e shtetërore, mund të drejtohet e të zhvillohet me sukses të madh dhe të mos braktiset vendlindja! Jeton në mes të popullit të Tij ku ka lindur!

tjerë!

Jeton Udhëheqësi aty afér pusit(bunarit) të ujit, që pushtuesit serb pasi ia kishin vrarë të parët e Tij, mbi 60 ia kishin hedhur në Të, e kishin mbushur në vend të ujit!

Mund ta merrni me mend se çfarë serioziteti të jetës, punës e veprës së Ali Ahmetit, i jep fakti se në çdo mengjes e në çdo mbrëmje kalon përrreth atij bunari që ishte i mbushur me njerez të fisit të Tij!

Se Udhëheqësi modern i popullit shqiptar Ali Ahmeti, nuk e braktisë truallin e shtëpisë ku ka ardhur në jetë, por nga aty drejton me sukses me fatet e popullit dhe Atdheut dhe projekton jetën e mirë të popullit dhe të ardhmen e ndritur të

Kombit shqiptar, kjo është një porosi e mesazh i madh që ju jepet politikanëve të korruptuar e atyre që mendojnë të zhvatin e të vjedhin djersen dhe pasurinë e popullit!

Në luftën për liri, çlirim

kombëtar e barazi nationale, për prosperim kombëtar e njerëzor, të popullit shqiptar në ish-Jugosllavi, të Kosovës e të popullit shqiptar e të vetë shtetit në Maqedoninë e Veriut, Udhëheqësi Ali Ahmeti, ka një vend të madh e të rëndësishëm, që kurrë nuk do të arrihet nga figurat e personalitetet që jetojnë aktualisht dhe vështirë se do të tejkalohet nga brezat që do të vijnë!

Udhëheqësi i popullit shqiptar Ali Ahmeti, gjumin e netëve të jetës së Tij e bën në truallin e të parëve, në shtëpinë e Tij në fshatin e lindjes në Zajaz!

Kjo jetë e këtillë, është pasqyra reale e jetës së liderit që nuk i intereson pasuria as lloksi i shfrenuar, por jeta dhe mirëqenia e popullit të Tij dhe jeta e mirë e qytetarëve të shtetit të Maqedonisë së Veriut!

Ali Ahmeti, Udhëheqësi i popullit shqiptar, jeton në fshatin e Tij të lindjes në Zajaz!

Prishtinë, më 24 Shkurt 2020!

Një autore që hedh hapin guximshëm dhe suksesshëm në letërsinë përfëmijë

(Fragmente nga shënimet për shkrimtaren Dritë Ruhani dhe kolanën e saj prej 12 librash)

Prof. As. Dr. Astrit BISHQEMLI

Subjeti.. kompozicioni

E tërë kolana është një korpus prozash të shkurtra artistike përfëmijë me një gjetje të këndshme "tregime përfëmijë të mbëbë". Kjo bashkësi copëzash kësishoj, e parë nga larg, formon një mozaik të bukur letrar. Fragmentarizmi sfumohet pa të rënë fort në sy. Secili vëllim më tepër ka formën e një tollumbaci, të cilën mund ta fryje ende. E pra, secili vëllim ka formën e një antologjje me tematikë të caktuar.

Autorja e ka lënë numërimin me aq ditë sa ka muaji referues (pjesa e parë vendoset në muajin janar, e dyta - në shkurt e me radhë). Egjithë kolana është konceptuar me 12 libra, sa muaj ka viti. Lexuesit, - prindi qoftë, i afërm tjetër i familjes, mësuesja a vetë fëmija - i serviret një tregim përfëmijë natë. Kësishoj, çdo vëllim i ngjan më tepër një novele a romani; ndonjëri madje një reportazhi që pëershkruan një udhëtim nëpër Shqipëri.

Veçori e përbashkët kompozicionale e librave të Dritë Ruhani është se ata e ndërtojnë veprimin mbi dylinja karakteristike: atë të njerëzve dhe atë të kafshëve (qenve). Këto dy linja herë ecin paralelisht, herë mbizotëron njëra e herë tjetra, herë kryqëzohen, përplasen a bashkohen e udhëtojnë së bashku. I gjithë libri i tretë, për shembull, është fantastik. Ngjarja a veprimi pothuajse zhvillohet ndërmjet qenve. Në pjesën e nëntë "O vendi im!", veçori është se mbizotëron linja njerëzore. Qysh në kreun e parë "Rilindje", kemi zotëri Dimalin që mban në duar fotografinë e Marës dhe mediton me vete rrëth saj...

Në kërkim të së resë

E lexojmë kolanën e librave të zonjës Ruhani dhe në fund i shtrojmë vetes pyjet: Cila është e reja që sjell kjo autore në letërsinë shqipe përfëmijë e të rinj?

Së pari mendja na shkon te sasia, te bashkësia prej 12 copë librash, të cilat i lidhin personazhet e njëjtë. Jo, letërsia jonë shqipe përfëmijë, këndeje e andej kufirit të shtetit shqiptar, njeh shkrimtarë që kanë botuar të tillë kolana. Mos ndoshta e reja qëndron te tematika, jeta e qenve? Nuk besojmë. Tregime mbi jetën e qenve kanë shkruar e botuar autorë që nga Naim Frashëri e këtej. Atëherë?

Mendimi ynë është se e reja që sjell Dritë Ruhani me kolanën e saj përfentë qëndron jo vetëm në trajtimin e një teme aq gjerë e aq thekshëm, por edhe në idetë që sjell kjo shkrimtarë.

Madje, është një problem i madh shqëror. Autorja bën kryepersonazhe qentë endacakë në Prishtinë, por edhe në Tiranë ku gjendja paraqitet ende më keq.

Zgjohet shpirti gazetaresk

Si ish-gazetare, autorja edhe në pozitën e saj të re si shkrimtare, na ngrë me guxim një sërë problemesh shoqërore të tjera në këtë kolanë librash. Veçse tanë (në romane e jo më nëpër gazeta) ato mvishen me petk letrar.

Si më të nxehtin do të vlerësonim atë të fesë (vëllimi V), veprimin e disa shoqatave humanitare të rrejshme, siç është ajo që ndihmon familje të tëra me ushqim, me kusht që të shtojë numrin e besimtarëve myslimanë. Këtë problem tanë autorja e trajton të mveshur me petk artistik, me një rast konkret. Tregon përfëmijë familje në nevojë, ku vajzës Arbëresha, i kërkijnë që të braktisë shkollën e mesme të arsimtë përgjithshëm, të mbulohet e të vazhdojë medresenë...

Edhe gjetkë, gratë besimtare të mbuluar, autorja i sheh vrëngër, me sy jo të mirë. Diku njërsë prej tyre sikur ia ndyn pak mantelin një qenushë-nënë, tek mbarte e gjora këlyshin e saj të pajetë, dhe grua i kthehet kafshës me mallkimin: "Oh Zot, plasësh!"

Autorja qorton edhe ndonjë gazetar të huaj për reportazhim e tij të realizuar në Kosovë: "Emisionet e huaja çdo herë e tregojnë qytetin tonë përmes fotove me xhamia, sikur të ishte ndonjë qytet nga shtetet arabe." (IV, 64)

Në kolanën letrare gjelqjnë edhe një tufë problemesh të tjera shoqërore bashkëkohore, si:

- Herë pas here, në detaje të veçanta, na rikujtohet Kosova heroike me luftën e saj qëndrestare.

- Futet edhe lufta në Siri, ku kanë marrë pjesë disa kosovarë dhe pasojat e renda të saj. Autorja e quan "luftë e kotë" dhe vë gishtin te traumat e saj me një rast konkret: përfëmijë përfëmijë, vajza personazhe vetëplagoset.

Nuk mungojnë në kolanë probleme të politikës shqiptare:

- Ngacmohet problemi i partive, i pasurimit të disa njerëzve nga ato.

- Tek trajtohet çështja e gardhit që duhet hequr midis dy fqinjëve, autorja gjuan më larg, aludon përfëmijë përfëmijë, të shpendëve e të kandrrave në përgjithësi (kujtojmë macet, bletët etj.) dhe atë të qenve në veçanti. Në të gjithë kolanën veprojnë si personazhe një bashkësi e tërë qenesh të rracave të ndryshme: Koko, Agena, Pastori, Bulldogu, familja Haski, Mjalta, Loçkushi, Syrrushi, Liza, Goldi, Lala e të tjerë e të tjerë. Dhe përfëmijë përfëmijë, të qenë se këtë libra u adresohen, në radhë të parë,

Kemi pastaj probleme të jetës shoqërore:

- "Gratë nuk mund të trashëgojnë! Meshkujt janë gllabërues të pronave".

- Shitblerja e fëmijëve.

Nuk mungojnë probleme të qytetit:

- Pastërtia e mjedisit.

- Rastet ku bisnesmenë a fabrikantë të korruptuar sjellin nga Jashtë ushqime të skaduara dhe ua ndërrojnë etiketat...

-...në tërë qytetin nuk kemi asnjë këshillimore përfëmijë qenve.

Më tej, nuk harrohen edhe probleme të fshatit:

- Fshatarët nuk kanë treg përfëmijë përfëmijë, e prodhimeve të tyre bujqësore e



blegtorale, të cilat u shkojnë dëm... Etj. etj.

Dora e gazetares duket edhe në episode të tjera, p.sh, kur rrëfen që në kishën e qytetit Velbert të Gjermanisë prifti gjerman kishte organizuar një meshë kushtuar Kosovës...

A nuk dëshmojnë tere këta shembuj, e të tjerë që nuk i përmendëm, përfëmijë përfëmijë, të mbulohet e të vazhdojë vërtetë luftarak qytetar të autores Dritë Ruhani?

Vektori i përparruar shkencor

Konstatojmë me kënaqësi që gjegjografia e krijimeve është bukur e gjérë. Diku direkt, diku indirekt, veprimi i tregimeve vendoset në vende të njohura e të shkelura, të përfjetura nga autorja. Koha e ngjarjeve brenda seccilit vëllim kufizohet brenda një muaji të caktuar. Por kemi kujtime të një kohe më të gjérë.

Si anë pozitive të kolanës mund të shënojmë se lexuesi përfiton njohuri nga gjegjografia e Shqipërisë. Kështu, marrim njohuri (veç Prishtinës e rethinave të saj) edhe përfjetura nga autorja. Koha e ngjarjeve brenda seccilit vëllim kufizohet brenda një muaji të caktuar. Por kemi kujtime të një kohe më të gjérë.

Si anë pozitive të kolanës mund të shënojmë se lexuesi përfiton njohuri nga gjegjografia e Shqipërisë. Kështu, marrim njohuri (veç Prishtinës e rethinave të saj) edhe përfjetura nga autorja. Koha e ngjarjeve brenda seccilit vëllim kufizohet brenda një muaji të caktuar. Por kemi kujtime të një kohe më të gjérë.

Por gjithsesi, më dominuese në kolanë janë dijenitë përfitona njohuri nga gjegjografia e Shqipërisë. Kështu, marrim njohuri (veç Prishtinës e rethinave të saj) edhe përfjetura nga autorja. Koha e ngjarjeve brenda seccilit vëllim kufizohet brenda një muaji të caktuar. Por kemi kujtime të një kohe më të gjérë.

Por gjithsesi, më dominuese në kolanë janë dijenitë përfitona njohuri nga gjegjografia e Shqipërisë. Kështu, marrim njohuri (veç Prishtinës e rethinave të saj) edhe përfjetura nga autorja. Koha e ngjarjeve brenda seccilit vëllim kufizohet brenda një muaji të caktuar. Por kemi kujtime të një kohe më të gjérë.

Dhe vlerësojmë se autorja ka dijeni të gjëra shkencore përfitona njohuri nga gjegjografia e Shqipërisë. Kështu, marrim njohuri (veç Prishtinës e rethinave të saj) edhe përfjetura nga autorja. Koha e ngjarjeve brenda seccilit vëllim kufizohet brenda një muaji të caktuar. Por kemi kujtime të një kohe më të gjérë.

Dhe vlerësojmë se autorja ka dijeni të gjëra shkencore përfitona njohuri nga gjegjografia e Shqipërisë. Kështu, marrim njohuri (veç Prishtinës e rethinave të saj) edhe përfjetura nga autorja. Koha e ngjarjeve brenda seccilit vëllim kufizohet brenda një muaji të caktuar. Por kemi kujtime të një kohe më të gjérë.

Dhe vlerësojmë se autorja ka dijeni të gjëra shkencore përfitona njohuri nga gjegjografia e Shqipërisë. Kështu, marrim njohuri (veç Prishtinës e rethinave të saj) edhe përfjetura nga autorja. Koha e ngjarjeve brenda seccilit vëllim kufizohet brenda një muaji të caktuar. Por kemi kujtime të një kohe më të gjérë.

Dhe vlerësojmë se autorja ka dijeni të gjëra shkencore përfitona njohuri nga gjegjografia e Shqipërisë. Kështu, marrim njohuri (veç Prishtinës e rethinave të saj) edhe përfjetura nga autorja. Koha e ngjarjeve brenda seccilit vëllim kufizohet brenda një muaji të caktuar. Por kemi kujtime të një kohe më të gjérë.

Dhe vlerësojmë se autorja ka dijeni të gjëra shkencore përfitona njohuri nga gjegjografia e Shqipërisë. Kështu, marrim njohuri (veç Prishtinës e rethinave të saj) edhe përfjetura nga autorja. Koha e ngjarjeve brenda seccilit vëllim kufizohet brenda një muaji të caktuar. Por kemi kujtime të një kohe më të gjérë.

Dhe vlerësojmë se autorja ka dijeni të gjëra shkencore përfitona njohuri nga gjegjografia e Shqipërisë. Kështu, marrim njohuri (veç Prishtinës e rethinave të saj) edhe përfjetura nga autorja. Koha e ngjarjeve brenda seccilit vëllim kufizohet brenda një muaji të caktuar. Por kemi kujtime të një kohe më të gjérë.

Dhe vlerësojmë se autorja ka dijeni të gjëra shkencore përfitona njohuri nga gjegjografia e Shqipërisë. Kështu, marrim njohuri (veç Prishtinës e rethinave të saj) edhe përfjetura nga autorja. Koha e ngjarjeve brenda seccilit vëllim kufizohet brenda një muaji të caktuar. Por kemi kujtime të një kohe më të gjérë.

Dhe vlerësojmë se autorja ka dijeni të gjëra shkencore përfitona njohuri nga gjegjografia e Shqipërisë. Kështu, marrim njohuri (veç Prishtinës e rethinave të saj) edhe përfjetura nga autorja. Koha e ngjarjeve brenda seccilit vëllim kufizohet brenda një muaji të caktuar. Por kemi kujtime të një kohe më të gjérë.

Dhe vlerësojmë se autorja ka dijeni të gjëra shkencore përfitona njohuri nga gjegjografia e Shqipërisë. Kështu, marrim njohuri (veç Prishtinës e rethinave të saj) edhe përfjetura nga autorja. Koha e ngjarjeve brenda seccilit vëllim kufizohet brenda një muaji të caktuar. Por kemi kujtime të një kohe më të gjérë.

Ha-ha-ha,- u qesh ai.- Ky bukuroshi nuk ka dhuratë përfëmijë. Ai vjen çdo ditë, në kohë të njëjtë, përfëmijë, të blerë ushqim tek unë. Më paguan me një gjeth"

Rasti i veçantë është humor anekdotik i pranishëm. Një mori anekdotash tregohen nga ana e Rromit në çdo vëllim të kolanës. Ja:

"A e dini që fjala matematikë rrjedh nga shqipja, nga një shqiptar që ka kaluar shumë duke mësuar dhe pastaj ka ikur: mat e mat, mat e mat, mat e mat - ikë"

Këto anekdota jo vetëm që e individualizojnë Ronin si karakter, por e bëjnë tekstin tërheqës përfëmuesin fëmijë.

Së fundi, vëmë në dukje që përvëç humorit, autorja përdor me sukses shumë frazeologji populllore e fjalë të urta, si:

...edhe te njeriu më i mirë fshihet një tigër;

...ai që mbjell erën, do të korrë furtunën;

- Fatit si t'i thërrash ashtu të përgjigjet;

- Çdo qen ka hijen e vet;

- kafshata e madhe ta zë fyti;

- Mos e prek në bisht, se të ha në gisht;

...nëse nuk do që muzgut t'i kërkosh lëmoshë, përaqoje mëngjesin me vrull pune;

- Njerëz të tillë, që me gojë të lajnë e me dhëmbë të cajnë...

- Gjuha kocka s'ka, por kocka thyer;

- Fusha ka sy e gardhi ka veshë etj.

Nuk mund të lëmë pa përmendur peizazhet e bukur që përfëmuesit. Herë-herë autorja. Ja një i tillë:

"Edhe pse kemi hyrë në pranverë, mëngjesi sot gdhiu i mbuluar me borë. (...) Sidomos manushaqet, ashtu me kokën e qitun jashtë, dukesin sikur po flinin në shtrat të bardhë. Një kombinim shumë i bukur ngjyrash, por disi rrëqethës. Një peizazh me pranverë e dimër në një, që me mëngjes brohoriste:

"Jam një pranverë e bardhë, një pranverë e bardhë përrallore!" (IV, 5).

Të gjitha këto dukuri që renditëm padishim që përbëjnë vlerë artistike në pendën e shkrimtare.

Vlerësuam që shkrimtarja vërtet ka stil të rrjedhshëm dhe të përshtatshëm përfëmuesin fëmijë. Le t'u gjëzohemi pozitivitetëve të padiskuteshme që na ka sjellë shkrimtarja Dritë Ruhani dhe që patjetër e pasurojnë letërsinë tonë shqipe përfëmijë.

Duke përfunduar, shtojmë edhe diçka informative. E py

E rrallë

Ushqimin që e varrosi në kopsht, burri vendosi ta hante pas 14 muajsh

Një burrë varrosi një hamburger në kopshtin e mikut të tij dhe e hengri atë më shumë se një vit më vonë. Sipas mediave të huaja, Matt Nadin, 40 vjeç, nga Barnsley, South Yorkshire, gjithmonë ka qenë krenar përfshirë aftësinë e tij përfshirë hengri.



bërë një gropë në oborrin e shtëpisë së mikut të tij Andy Thompson dhe varrosi ushqimin në një kuti dhe pas 14 muajsh e hengri.

FOTO E DITES



Një ushtar i Forcave Tokësore të Republikës së Shqipërisë shihet në pozicionin e gjuajtjes në Shenjë.

E jashtëzakonshme

Zbulohet shpella me trupat e 72 anëtarëve të një fisi të zhdukur para 1 000 vjetësh

Arkeologët amatorë e kanë zbuluar me ndihmën e dronit një shpellë të lashtë në ishullin Gran Canaria të Spanjës, ku ndodhen mbetjet e trupave të 72 personave. Në hapësirat e shpellës së lashtë janë gjetur mbetjet e 62 të rriturve dhe dhjetë fëmijëve



që janë zhdukur pa gjurmë para 1 000 vjetësh më parë dhe i përkisnin fisit para hispanik të njohur si Guanche. Sipas agjencisë arkeologjike të asaj zone, është thënë se ata kanë jetuar nga shekulli i VIII-të deri në shekullin e X-të.

**DASHI**

Komunikimi është shumë i rëndësishëm në këto ditë. Jo vetëm në marrëdhëniet profesionale, por edhe martesa kërkon një dialog të hapur dhe të sinqertë.

**DEMI**

Hëna paraqet një kontribut të shkëlqyeshëm si përgjendjen shpirtërore, po ashtu edhe për ngjarjet që mund ta karakterizojnë ditën.

**BINJAKËT**

Mos hiqni dorë përpëra një situate në të cilën është mirë të luftoni e ta zgjidhni atë. Tregoni vendosmërinë që nuk ju mungon.

**GAFORRJA**
Le të fillojmë nga pasioni i dashurisë.

Takimet e papritura mund të bashkojnë dy njerëz shumë të ndryshëm së bashku.

**LUANI**

Mundohuni të mos përfshiheni shumë te dikush që është në vështirësi: ai mund të ketë përgjegjësitet e tij dhe nuk ju takon juve t'i zgjidhni problemet e botës!

**VIRGJËRESHA**

Një ditë tjetër gri për Virgjëreshën, sigurisht e kërkuar. Marrëdhëniet, si martesore ashtu edhe shoqërore, janë në shënjestë.

**PESHORJA**

Do të karakterizoheni nga imaginata, saktësia, vëmendja, besueshmëria dhe ekzekutimi i përsosur në çdo detaj!

**AKREPI**

Sidomos në punë, mban sytë tuaj të mprehtë, jini në vëzhgim. Kjo ditë mund t'ju ofrojë marrëveshje shumë interesante.

**SHIGJETARI**

Disa re kalojnë në qellin tuaj. Gjatë kësaj dite është e përshtatshme të qëndroni të qetë dhe të mos pretendoni të zgjidhni gjithçka brenda një momenti.

**BRICJAPI**

Do të keni mundësi të ktheni një situatë, financiare ose sentimentale në avansazhun tuaj, ku deri dje ishte në disavantazh.

**UJORI**

Me Diellin dhe Hënën në kampin e dytë, ju merrni një injekzion të dobishëm besimi dhe entuziazmi!

**PESHQIT**

Një ditë e shkëlqyeshme përtë gjithë ata që kryejnë një aktivitet që kërkon komunikim dhe shoqërueshmëri.

BARSOLETA E DITËS



Një çift del në piknik e natën e kalon në shator. Në gjysmë të natës eçon grua burrin dhe i thotë:

- Shiko lart çka po sheh?

Burri:

- Po shoh hënën dhe yjet.

Gruaja:

- More budalla, a nuk po sheh se na kanë vjedhur shatorin?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 **Spies in Disguise 3D**

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 **Jumanji; The Next Level 3D**

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 **STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D**

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj


Regjia: J.J. Abrams

Çdo natë në ora 22:30 **THE GRUDGE**

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea DuVall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

Jennifer Lopez i thotë “Po” Alex Rodriguezit



Jennifer Lopezi dhe Alex Rodriguezi ndodheshin në Bahamas, ku ai u ul në gjunjë breg të detit me një unazë diamant në dorë dhe i propozoi martesë. Këngëtarja e emocionuar i tha “Po”. Por, pas një viti, më në fund çifti ka vendosur

ta organizojnë ceremoninë e dasmës që do të ngelet në mendjen e të gjithëve. Burime për “Life and Style” kanë treguar se çifti ka në plan të shpenzojë rreth tre milionë dollarë për këtë ceremoni që dëshirojnë ta mbajnë mend gjithë jetën.

The Weeknd flet për konsumimin e substancave narkotike



The Weeknd ka folur së fundmi për marrëdhënien me drogën disa ditë pasi publikoi një këngë të re duke iu referuar zemrës së tij të thyer. Në një intervistë të re me “CR Men's Issue 10”, këngëtar 30-vjeçar tregoi historinë e vet me drogën. “Unë kam një marrëdhënie

të jashtëligjshme me të. Nuk e konsumon jetën time, por herë pas here më ndihmon ta hap mendjen, veçanërisht kur jam duke krijuar, por kur performoj jam plotësisht i matur dhe përpinqem të mos pi”, ka pohuar muzikanti i njohur, emri i vërtetë i të cilit është Abel Tesfaye.



Harry dhe Meghan do të përfitojnë shuma të majme edhe nga “Instagram”-i

Pas vendimit për t'u larguar nga familja mbretërore, fansat e princi Harry dhe Meghan Markle filluan të shqetësohen për burimin e të hyrave të tyre. Mirëpo, meqenëse janë shndërruar në sensacion botërор dha janë bërë akoma më të famshëm

sesa kanë qenë, përfitimet e tyre vetëm sa mund të rriten. Sipas të dhënave të një platforme marketingu, çifti i popullarizuar mund të përfitojë më shumë se 110 000 dollarë (101 700 euro) për një postim në “Instagram”, shkruan “The Sun”.

“Askush nuk të do sa unë”, Selena Gomez i këndon sërisht dashurisë së dikurshme



Selena Gomez e ka kujtuar ish të dashurin në këngën e re “Feel Me”. Kënga e re e cila është publikuar më 20 shkurt është pjesë e albumit “Rare”. Në këngën trem-inutëshe, Selena i përshkruan emocionet e thella dhe i dërgon një mesazh ish të dashurit: “Askush nuk

të do sa unë”. Natyrisht se fansat menjëherë kanë aluduar te lidhja e saj e shumëpërfolur me këngëtarin Justin Bieber, i cili tashmë është i martuar me Hailey Baldwin. Albumi i ri, “Rare”, është albumi i tretë i këngëtares, i cili është publikuar më 10 janar përmes Interscope Records.

Hoxha: Synojmë fitore kundër Prishtinës në 'Fadil Vokrrin'



Arbër Hoxha i Ballkanit është qind për qind i fokusuar në skuadrën e Ballkanit. Ai ka thënë për "Epokën e re" se synon të fitojë tituj me këtë klub e më pas të mendojë për Evropë. E për ndeshjen e radhës kundër Prishtinës paralajmëron fitore. "Ndeshja e radhës me Prishtinën do të jetë mjaft e fortë duke marrë parasysh se në radhët e veta ka lojtarë cilësorë dhe me provojë. Në këtë ndeshje shkojmë për rezultat pozitiv, pse jo mos të dalim edhe me tri pikë të plota", ka thënë Hoxha

**EPOKA
ERE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 SHKURT - Futbollisti Arbër Hoxha është një prej lojtarëve kryesorë në skuadrën e Ballkanit në këtë edicion të garave. I kontaktuar të hënën nga redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re", Shala ka folur për sukseset e gjermanishme të klubit nga Suhareka. "Është e vërtetë se po kalojmë nëpër një formë të mirë edhe në pranverë. Në këtë formë dhe te suksesi kemi arritur si rezultat i punës së madhe të kryesisë së klubit, shtabit teknik e deri te lojtarët që jemi të bashkuar për qëllimin madhor: të arrijmë një sukses historik në këtë edicion garash", ka thënë Hoxha.

Ballkani ka realizuar dy fitore në dy ndeshjet e para të sezonit pranveror ndaj Drenicës dhe Ferizajt, por testin e parë serioz e ka në fundjavë kundër

Prishtinës. Kjo ndeshje zhvillohet të shtunën nga ora 17:00 në stadiumin "Fadil Vokri". Hoxha lidhur me synimet e klubit aktual ndaj ish-klubit ka thënë se në kryeqytet synohet rezultati pozitiv, pse jo edhe fitorja. "Ndeshja e radhës me Prishtinën do të jetë mjaft e fortë duke e marrë parasysh se ata në radhët e veta posejnjë lojtarë cilësorë dhe me provojë. Në këtë ndeshje shkojmë për rezultat pozitiv, pse mos të dalim edhe me tri pikë të plota", ka thënë Hoxha.

Skuadra nga Suhareka është e sukseshme edhe në garën e Kupës, ku në gjysmëfinale do të takohet me Feronikelin që është fitues i Kupës dhe kampion në fuqi. "Në gjysmëfinale kundërshtar e kemi një skuadër shumë të fortë siç është Feronikeli, kampion aktual. Tash është herët të mendojmë për ato dy ndeshje, pasi para vetes kemi ndeshje shumë të rëndësishme

në kampionat, por besojmë se do të kualifikohemi në finale dhe më pas ta fitojmë edhe Kupën", ka shtuar ai. "Për të qenë realist më duhet të them se nuk jam duke menduar aspak për ofertat personale, pasi në rend të parë është suksesi i Ballkanit, sepse falë tyre gjendem në këtë formë. Jam i fokusuar 100 % këtu për arritjen e objektivave, pastaj do të ulem me klubin dhe t'i shqyrtojmë ofertat të cilat kanë ardhur në adresë të klubit dhe ta bëj zgjedhjen më të mirë", ka përfunduar Hoxha, i cili është lojtar premtues dhe shihet si e ardhmja e Përfaqësueses së Kosovës në futboll. Ai ishte i ftuar në ndeshjen miqësore që Kosova e zhvilloi në muajin janar kundër Suedisë. Skuadra që drejtohet nga Ismet Munishi, Ballkani, mban vendin e parë me 40 pikë. Nga nëntëmbëdhjetë ndeshjet e zhvilluara ka regjistruar 12 fitore, 4 barazime dhe 3 humbje.

KOK-u përzgjedh 10 Shpresat Olimpike 2020

PRISHTINË, 24 SHKURT - Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës në mbledhjen e fundit bëri përzgjedjen e 10 Shpresave Olimpike 2020, të cilat do të paguhën nga KOK-u për 12 muajt e këtij viti. Për herë të parë KOK-u ka vendosur ta

çojë në 10 numrin e Shpresave, nga 6 sosh sa ishte për vitin 2019. Listës i prijnë notari Arti Krasniqi, xhudistja Fatjona Kasapi, si dhe karateisti Betim Maliqi. Atletika është sporti i vetëm që përfaqësohet me dy garues: Albina Deliu dhe

Alaudin Suma. Besart Pireva është nga boksi, ndërsa lista pasohet me Edi Dvorani (shigjetari), Njomëza Nuraj (taekwondo), Vesa Gjinaj (tenis) dhe Fatlum Braka (mundje). Të gjithë sportistët e rinj do të marrin pagë mujore në vlerë

100 euro në muaj. Krahas këtyre 10 Shpresave, BE i KOK-ut në fund të vitit 2019 përzgjodhi edhe 10 Shpresa Olimpike 2020, të cilat do të marrin paga mujore në vlerë 150 euro nga Ministria për Kulturë, Rini e Sport. Kjo është



hera e parë që KOK-u dhe MKRS-ja japin 20 paga mujore për 20 Shpresa Olimpike 2020.

SHKURT

Ramaj: Ende nuk jemi në bisedime me asnjë trajner

Skuadra e Feronikelit ende nuk e ka emëruar trajnerin e ri. Të shtunën skuadra kampione në fuqi e Kosovës, Feronikeli, i ka ndarë rrugët me trajnerin Agim Sopi. "Momentalisht nuk jemi në bisedime me askënd. Çdo emër që del në media deri tash është vetëm thashetheme. Do t'ju njoftojmë me kohë për më të rejat", ka thënë presidenti i "Niklit", Naser Ramaj, për "Olle". Deri tash skuadra nga Drenasi ka ndërruar dy trajnerë.

Barça e kërkon Kumbullën

Vlera e mbrojtësit të Kombëtares së Shqipërisë, Marash Kumbulla, është rritur shumë në këtë edicion. Ai po shkëlqen me fanellën e Veronës dhe shumë klubë të mëdha janë në garë për transferimin e tij. Manchester City, Manchester Unitedi dhe Chelsea nga Anglia, Bayern Muncheni dhe Borussia Dortmundi në Gjermani si dhe Napoli dhe Interi në Serinë A kanë shfaqur deri tash interesim për shqiptarin. "Tuttohellasverona" raporton se Barcelona ka shprehur dëshirën për t'i marrë shërbimet e Kumbullës, i cili do të rritej afér Gerard Piques.

Xhaka: Nëse më ofrohet shiriti i kapitenit përsëri do të mendoj dy herë

Granit Xhaka ka zbuluar se koha kur Arsenali vendosi ta marrë shiritin e kapitenit të skuadrës ka qenë periudha më e vështirë në karrierën e tij dhe se kishte pasur frikë se nuk do të luante kurrë më për klubin londinez. Mesfushori shqiptar thotë se do të mendoj dy herë nëse i ofrohet mundësia për t'u bërë kapiten përsëri. "Natyrish, nuk mund t'ju gënjej. E mendova në atë moment, sepse nuk ka qenë e lehtë për mua dhe familjen time. Shpresoj se njerëzit më kuptojnë. Por mendoj se tregova karakter. Unë nuk jam person që ik. Gjithmonë i them klubit: 'Përderisa të jem këtu, do të jap gjithçka nga vetja'. Gjithmonë ka qenë kështu", ka thënë Xhaka. "Unë e di çfarë mund t'i ofroj këtij ekipi me apo pa shiritin e kapitenit. Nuk desha ta pranoj shiritin e kapitenit kundër Palace, por Sokratis dhe David Luiz më thanë se duhej ta pranoja. Nëse një ditë klubti më kërkon të bëhem kapiten, do të mendoj dy herë", ka shtuar Xhaka.

Lirika Deva e artë, Elena Hoxha e bronztë në Turqia

PRISHTINË, 24 SHKURT - Skitaret e Kosovës, Lirika Deva dhe Elena Hoxha, kanë fituar medalje në garën ndërkombe të Federatës Ndërkombe të Skitarisë (FIS), që po mbahet për grupmosha të reja në

Olludag të Turqisë. Deva fitoi medaljen e artë, ndërsa Hoxha të bronztën në grupmoshën U-14, disiplina sllalom. Lirika pati kohën 1:18.88 sekonda nga të dyja lëshimet, ndërsa Elena përfundoi me kohë 1:22.43

sekonda. Në këtë grupmoshë, Enxhi Sefaj doli e shtata me kohë 1:24.64. Pjesëmarrës ishin 17 garuese. Afër medaljes ishte edhe Kiana Kryeziu në U-16, disiplina sllallom, duke dalë e katërtë. Në këtë grupmoshë, e



Dy superndeshje në Ligë e Kampionëve

NAPOLI, 24 SHKURT - Skuadra e Barcelonës udhëton në Itali për t'u përbaltur me Napolin në ndeshjen e parë të 1/8 së finales në Ligën e Kampionëve. Të dyja këto skuadra në ndeshjet e fundit kampionate kanë treguar formë të mirë dhe kanë arritur disa fitore radhazi. Barcelona e ka rimarrë kryesimin në La Liga pas fitores në fundjavë ndaj Eibarit (5-0), kurse vlen të ceket se në këtë ndeshje Lionel Messi ka shënuar plot katër gola. Gennaro Gattuso gjeti mjaft probleme kur mori drejtimin e Napolit dhe si pasojë humbi katër nga gjashtë ndeshjet e para. Kjo bëri që Napoli të bie në mesin e tabelës, çka nuk ishte e zakonshme për këtë klub në vitet e fundit. Tash ky klub është rikthyer dhe është duke luftuar për një vend që dërgon në Ligën e Kampionëve sezonal e ardhshëm.

TË MARTËN TAKOHEN:
21:00 Napoli - Barcelona
21:00 Chelsea - Bayern München



do të përballemi me një ekip të shkëlqyer. Do të jem i kënaqur nëse luajmë me kokën lart, pa frikë. Ne e respektojmë kundër shtarin, por duam ta mundim atë. Kafaz për Messin? Nuk është vetëm ai te Barcelona, do të duhet të zhvillojmë një lojë të shkëlqyeshme në nivel kolektiv. Për mua, Messi është lojtari më i madh, për mënyrën si e ka jetuar karrierën e tij, një shembull përfutbollin botëror. Asnjëherë, asnjë fjalë jashtë vendit. Lojtar dhe njeri i përsosur. E shoh atë të bëjë disa gjëra

që njerëzit zakonisht i bëjnë në 'playstation'. Messi është më i miri i të gjitha kohëve", ka thënë Gattuso. Ndeshje interesante do të zhvillohet edhe në Angli në mes të Chelseat dhe Bayern Munchenit. Chelsea do të luajë ndaj "bavarezëve" me motiv shumë të lartë, pasi shënoi fitore në ndeshjen e fundit kundër Tottenham Hotspurit (2-1), por edhe Bayerni e ka lart moralin sepse është ne vendin e parë në Bundesliga dhe ka marrë fitore në ndeshjen e fundit ndaj Paderbornit.

Lakersat në sekondat e fundit fitojnë ndaj Bostonit

Los Anxhelos, 24 shkurt - LA Lakers ka fituar në sekondat e fundit me rezultat 114-112 ndaj Bostonit, në një përballje klasike të NBA-së. Një ndeshje e ekwilibruar, ku të dyja ekipet luftuan fort deri në fund. Anthony Davis realizoi 32 pikë e 13 rebounde, mbështetur edhe nga LeBron Jamesi me 29 pikë, një dyshe që bëri diferençën në parket përvendësit. Tatum për Celticsin realizoi 41 pikë, por që mbetën për statistikë. Fitore të vështirë korri edhe Portlandi, që mundi me rezultat 107-104 Detroitin. McCollum me 41 pikë e 12 asistime si dhe veterani Carmelo

REZULTATET

Lakers - Boston	114-112
Denver - Minnesota	128-116
Toronto - Indiana	127-81
Chicago - Washington	126-117
Oklahoma - San Antonio	131-103
Golden State - New Orleans	101-115
Portland - Detroit	107-104



Anthony me 32 pikë ishin vendimtarë për Portlandin në këtë fitore. Oklahoma, falë një loje të mirë kolektive (7 lojtarë mbi 10 pikë), mundi me rezultat 131-103 San Antonion, ndërsa skuadra kampione e Torontos triumfoi me rezultat 127-81 ndaj Indianas. Ndeshje e dominuan nga kanadezët, ku u dallua Siakam me 21 pikë, raporton "Telesport". Skuadra e Denverit

korri një fitore të rëndësishme ndaj Minnesotas, duke fituar me rezultat 128-116, sukses që e mban ekipin e Nuggetsit mes pretendenteve në Perëndim. Millsap me 25 pikë e Jokiqi me 24 ishin dy shënuesit më të mirë të skuadrës. Fiton edhe Chicago, që mundi me rezultat 126-117 Washingtonin, me Cobu White (33 pikë) e LaVine (32 pikë), që bënë diferençën në parket.

SHKURT

Guardiola: Reali është mbret i Ligës së Kampionëve

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, e ka lartësuar Real Madridin duke e quajtur mbret të Ligës së Kampionëve, para duelit të mesjavës mes skuadrës së tij dhe 13 herë kampionit evropian. Guardiola ka shumë përvojë në përballje me Realin nga koha e tij si lojtar dhe më pas si trajner i rivales së përabetuar, Barcelonës, prandaj ai është në dijeni për detyrën e madhe që e pret Cityn. "Kam luajtur shumë herë ndaj këtij klubit si lojtar dhe si trajner dhe gjithmonë e kam admiruar shumë historinë e këtij klubit", ka thënë Guardiola. "E di sa e vështirë është të përballesh me cilësinë e këtyre lojtarëve. Nuk e di sa shumë finale i kanë luajtur ata apo sa herë e kanë fituar trofeun. Do të përpinqemi ta bëjmë më të mirën, duke e ditur se luajmë kundër mbretit të kësaj gare", ka deklaruar Guardiola.

Tifozët e PSG-së sulmojnë Silvën, Mbappen dhe Neymarin

Situata te PSG-ja nuk është aspak e mirë, aq më tepër edhe pas asaj humbje me Dortmundin në Ligën e Kampionëve, ku loja e ekipit francez nuk kënaqi aspak, duke ditur se nga të gjithë kërkohet fitori ja e këtij kompeticioni. Tifozët parisienë të pakënaqur nga skuadra e tyre kanë shpalosur një banderolë në ndeshjen ndaj Bordos, e fituar nga PSG-ja me rezultatin 4-3. Tifozët kanë "sulmuar" tre nga lojtarët më të mirë të ekipit, siç janë Thiago Silva, Kylian Mbappe dhe Neymar. Në drejtim të këtyre lojtarëve ka pasur një banderolë ku shkruhej: "Ju nuk keni personalitetin e duhur, pér këtë ekip". Pikërisht thuhet se të 3 këta futbollistë në merkaton e verës do të largohen nga ekipi francez, me destinacionet që nuk dihen ende.

Benzema: E vështirë ndeshja kundër Cityt

Sulmuesi i Real Madridit, Karim Benzema, ka thënë se ndeshja kundër Manchester Cityt të mërkurën do të jetë e vështirë. "Do të jetë një ndeshje e mirë, gjithçka përreth nesh është e çmendur dhe kjo është një presion shtesë për ne. Ta mbërrish paraqitjen e 100 jubilare është diçka fantastike dhe do ta shijoj këtë. Liga e Kampionëve dhyron diçka të vecantë", ka thënë Benzema.

Inter - Ludogorets zhvillohet pa shikues

Sfidja e kthimit e raundit të 1/8-ave në mes të Interit dhe bullgarëve të Ludogoretsit do të luhet të enjten në "San Siro" siç është në program, pavarësisht frikës nga Coronavirusi. Duke iu referuar asaj çfarë shkruajnë mediat italiane, kjo ndeshje do të luhet pasi skuadra zikaltër ka kalendar të ngjeshur dhe nuk ka data të lira për t'u riluajtur kjo sfidë më pas edhe për faktin se njëra mes dy skuadrave do të luajë në raundin e 1/8-ave me ndeshjet e para të kësaj faze që do të zhvillohen pas dy javësh. Kështu që të gjitha gjasat janë që Inter - Ludogorets të luhet të eniten, por pa praninë e tifozëve në stadium

**Fury konfirmon se e dëshiron meçin ndaj
Joshuas**

Tyson Fury ka konfirmuar se dëshiron të përballet me Anthony Joshuan nëse nuk ndodh pjesa e tretë e trilogisë me Deontay Wilderin. 31-vjeçari ia shkaktoi humbjen e parë në karrierë Bomberit të bronztë në rimeçin e zhvilluar gjatë fundjavës që lamë pas dhe ia rrëmbeu titullin WBC. Dueli i tyre i parë (dhjetor 2018) kishte përfunduar baras, ndërsa në marrëveshje e kanë një klauzolë edhe për duelin e tretë që do ta kompletonte trilogjinë mes tyre. Mirépo, nëse nuk ndodh meçi i tretë ndaj Wilderit, atëherë Fury është i gatshëm për atë që në Britani të Madhe po konsiderohet si 'dueli i shekullit', pra përballjen ndaj Joshuas - transmeton "The Sun". Gjatë një udhëtimi në stadiumin e Los Angeles Raiders, Tyson i ka thënë gazetares së boksit, Michelle Joy Phelps: "Nëse Deontay nuk e do rimeçin, atëherë shkojmë AJ...". Pas fitores ndaj Wilderit britaniku është bërë kampion bote në kategorinë e peshave të rënda në WBC, ndërsa të gjithë titujt e tjerë (IBO, IBF, WBA, WBO) i mban Joshua.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Drejtoria për Arsim dhe Edukim

Email: dkaemalisheva@gmail.com

Datë: 24.02.2020
Nr: 11/175

Drejtori për Arsim dhe Edukim në mbështetje të kontratës Kolektive neni 14 pika 7 nxjerrë këtë:

VENDIM Për anulimin e Konkursit të datës 18.02.2020 me nr: 11/141

1. Anulohet Konkursi i datës : 18.02.2020 i shpallur në gazeten ditore Epoka e Re për mësimdhënës të lëndës së biologjisë për 18 orë mësimi në javë në SHFMU " Naim Frashëri" në Banjë.
2. Vendimi hynë në fuqi pas nënshkrimit të tij

Arsyetim

Mbështetur në Kontratën Kolektive Neni 14 pika 7 për plotësim norme e në mungesë të numrit fizik për rekrutimin e punëtoreve të riqë në sistem, u vendos si në diapositiv të këtij vendimi .

Vendimi u dërgohet:

1. Drejtorit të SHFMU " Naim Frashëri" në Banjë z. Metë Krasniqi
2. Komisionit intervistues
3. Arkivit



MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO

Job Openings with Millennium Foundation Kosovo

Millennium Foundation Kosovo is the implementing entity of the Threshold Program agreed between the Government of the Republic of Kosovo and Millennium Challenge Corporation.

Kosovo Threshold Program addresses two key constraints to Kosovo's economic growth: an unreliable supply of electricity; and the real and perceived weakness in rule of law, government accountability and Transparency.


Millennium Challenge Kosovo is seeking qualified and dedicated professionals for the following two positions:

- Monitoring and Evaluation Specialist
- Energy Specialist

Information pack including the job descriptions and required qualifications, as well as the application forms for these positions can be downloaded at the MFK website: www.millenniumkosovo.org

Application period is until 11th of March at 17:00 CET. All applications should be sent in the provided template format at the following email address: office@milleniumkosovo.org

*Millennium Foundation Kosovo is equal opportunity employer and does not discriminate any employee or job applicant on the bases of race, creed, color, national origin, or sex.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS

QKMF-në Dr. "Shpëtim Robaj" në Malishevë
Nr. 107
Më: 24/02/2020

Drejtor i QKMF-se „Dr Shpëtim Robaj,, ne Malishevë,ne baze te Rekomandimit nr.07/29 te dt 22.02.2020 te DSHMS-se ne Malishevë,nenit 8 te ligjtit te punes nr 03/L-212 si dhe nenit 4 te udhezimit administrativ nr.7/2017,per rregullimin e procedurave per konkurs ne sektorin publik,per plotësimin e vendeve te punes publikon kete:

KONKURS Për pranim te:

- Një (1). Mjekë të prakëses së përgjithshme në kohe te pacaktuar.

Detyrat e punes;


Ofron sherbime shendetesore nga kujdesi primare shendetesor ne QKMF,QMF dhe AMF. Siguron kujdes primar shendetesor per te gjithe qytetaret pa dallim: kombi,feje,etnie,race,gjinie. Shkruan terapin ne baze te diagnostifikimit,udhezon pacientet ne Qendrat tjera spitalore,kryen te gjitha punet e Mjekut te Pergjitheshem ne baze te ligjit te shendetesise,bashkepunon me mjeket tjere,per punen e vete i përgjigjet shefit te Mjekesise Familjare dhe Drejtorit te QKMF-se.

Kushtet e konkursit:

- Diplomën e Fakultetit të Mjekësisë drejtimi i përgjithshëm.
- Licencën e punës
- Certifikatën e Lindjes
- Certifikatën e Mjekut- për punë.
- Certifikaten qe nuk eshte nene hetime
- Leternjoftimin e fotokopjuar.

Kohezgjata e kontrates:ne kohe te pacaktuar(pas periudhes provuse tre mujore)
-Oret javore te punes 40.

Konkursi mbetet i hapur 15 dite nga dita e publikimit ne Mjetet e informimit.
Aplikacionet e arritura pas afatit nuk pranohen,aplikaciont me dokumenta te pakompletuara nuk shqyrtohen.
Dokumentacionet dorezohen ne zyren e personelit te QKMF-se.



Drejtori QKMF-së
Dr. Nuhri Morina, ap. Pediatër

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

**Kërkoj kujdestare përvajzën 7 muajshe në Prishtinë.
Për informata në tel: 044-444-009**

► Sami Maxhuni shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Profesionale të Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Abdyl Frashëri" Prishtinë si dhe dëftesat e vitit të tretë dhe katërt.

► Sami Maxhuni shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të parë dhe të dytë të shkollës së mesme Profesionale Kimi-Teknologji në Vushtrri.

► Gazmend Rama, shpall te pavlefshme dëftesat e (kl. I - VIII) SHF. "Lirija" Turiqevc.

► Valdet Ferizi B.I shpall të pavlefshme nrb: 810684200.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepsë shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhammed Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banës me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhammed Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banës me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banës me qira garsoniere në Ulpijan kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpijan kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

Abedin Kuliqi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr personal N.T.N 70569485 me nr te biznesit 71036928 "Fresh City" me seli ne Skenderaj



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Agjencia Kosovare e Privatizimit është e ngarkuar për të privatizuar Ndërmarrjet Shqipërore në Kosovë përmes metodës së spin-off-it dhe likuidimit. Investitorët ftohen t'i blejnë përmes tenderit të hapur dhe konkurrues asetet e disa NSH-ve në likuidim të radhitura më poshtë.

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT SHPALL SHITJEN E 55-të TË ASETEVE TË NDËRMARRJEVE NË LIKUIDIM

Subjektet / njësitë e përcaktuara më poshtë janë nën juridikcionin e AKP-së në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-034 për Privatizim mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ofertat e mbyllura për njësitë në vijim duhet të dorëzohen në "Sallën e konferencave - Hotel Grand" në Prishtinë, më 25 mars 2020, ndërmjet orës 10:00 dhe 12:00 (sipas kohës lokale të Evropës Qendrore), dhe të shoqëruara nga depozita e ofertës dhe tarifa për paraqitjen e ofertës, siç është parashikuar për secilin artikull. Të gjitha ofertat duhet të paraqiten në përpunësje me Rregullat e Tenderit të zbatueshme për shitjet me likuidim. Të gjitha njësitë e radhitura këtu ofrohen për shitje mbi bazën "siç është" dhe "ku është" dhe do të shiten në përpunësje me termet ligjore dhe kushtet e shitjes. Veçanërisht dhe pa ndryshuar kushtet e tillë, AKP nuk jep garanci, qoftë të shprehur apo të nënkuptuar, sa i përket gjendjes apo përshkrimit të njësive që shiten ose përshtatshmërisë së tyre për ndonjë përdorim apo qëllim. Verifikimi i përshkrimit gjendej gjendjes së të gjithë njësive të listuara këtu është përgjegjësi e ofertuesit.

Njësia nr.01: Ramadan Agushi Toka në Pustenik (Lot B) - ofron për shitje tokën në sipërfaqe të përgjithshme prej 10977m² (1ha 09ari 77m²), në ZK dhe në afersi të fshatit Pustenik, Komuna e Han i Elezit, e cila është e përshtatshme për veprimitari bujqësore. (Depozita e ofertës: € 1,000)

Njësia nr.02: Ramadan Agushi Toka në Pustenik (Lot C) - ofron për shitje tokën në sipërfaqe të përgjithshme prej 19532m² (1ha 95ari 32m²), në ZK dhe në afersi të fshatit Pustenik, Komuna e Han i Elezit, e cila është e përshtatshme për veprimitari bujqësore. (Depozita e ofertës: € 2,000)

Njësia nr.03: Agromorava Toka në Sadovinë të Çerkezeve (Lot H) - ofron për shitje tokën bujqësore në sipërfaqe prej 19033m² (1ha 90ari 33m²), në ZK dhe në afersi të fshatit Sadovinë të Çerkezeve, në Komunë të Vitisë. Lokacioni është i përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme bujqësore. (Depozita e ofertës: € 3,000)

Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: P.I.P.P.Agronomara Viti (Fi-229/89)

Njësia nr.04: Tefik Çanga Toka në Busi (Lot B) - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqe prej 5628m² (56ari 28m²), në ZK dhe në afersi të fshatit Busi të Komunës së Prishtinës, e cila është e përshtatshme për veprimitari bujqësore. (Depozita e ofertës: € 2,000)

Njësia nr.05: Tefik Çanga Toka në Busi (Lot C) - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqe prej 2793m² (27ari 93m²), në ZK dhe në afersi të fshatit Sadovinë të Çerkezeve, në Komunë të Vitisë. Lokacioni është i përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme bujqësore. (Depozita e ofertës: € 1,000)

Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: NSH Kombinat i Drurit Tefik Çanga Ferizaj Fi-631/89, SHA Kombinat Industrial i Drurit Ferizaj Fi-6725/92

Njësia nr.06: Agromorava Toka në Sadovinë të Çerkezeve (Lot E) - ofron për shitje tokën bujqësore në sipërfaqe prej 77219m² (7ha 72ari 19m²), në ZK dhe në afersi të fshatit Sadovinë të Çerkezeve, në Komunë të Vitisë. Lokacioni është i përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme afarishte. (Depozita e ofertës: € 7,000)

Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: P.I.P.P.Agronomara Viti (Fi-229/89)

Njësia nr.07: PMN Sharr Toka në Bob (Lot B) - ofron për shitje tokën në sipërfaqe prej 1839m² (18ari 39m²), në ZK dhe në afersi të fshatit Bob, e cila është e përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme afarishte. (Depozita e ofertës: € 1,000)

Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: Sh.A "SHARR - Holding" DD "SAR-Holding" (Fi-605/89)

Njësia nr.08: Pasuria Bujqësore Toka në Rahovicë (Lot I) - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqe prej 766m² (7ari 66m²), në ZK dhe në afersi të fshatit Rahovicë në Komunën e Ferizajt, e cila është e përshtatshme për veprimitari bujqësore. (Depozita e ofertës: € 1,000)

Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: N.Sh. "Pasuria Bujqësore" Ferizaj (Fi-650/89)

Njësia nr.09: Ramadan Agushi Toka në Sadovinë të Çerkezeve (Lot A) - ofron për shitje tokën në sipërfaqe të përgjithshme prej 8801m² (88ari 01m²), në ZK dhe në afersi të fshatit Sadovinë të Çerkezeve, Komuna e Vitisë, e cila është e përshtatshme për veprimitari bujqësore. (Depozita e ofertës: € 2,000)

Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: KB "Ramadan Agushi" Kaçanik (Fi-1386/90)

Njësia nr.10: Agromorava Toka në Sadovinë të Çerkezeve (Lot C) - ofron për shitje tokën në sipërfaqe prej 21404m² (2ha 14ari 04m²), në ZK dhe në afersi të fshatit Sadovinë të Çerkezeve, në Komunë të Vitisë. Lokacioni është i përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme afarishte. (Depozita e ofertës: € 3,000)

Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: P.I.P.P.Agronomara Viti (Fi-229/89)

Njësia nr.11: KB Zhegëra Toka në Lladovë - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 5575m² (55ari 75m²), në ZK dhe në afersi të fshatit Lladovë, në Komunë të Gjilanit, e cila është e përshtatshme për veprimitari bujqësore. (Depozita e ofertës: € 2,000)

